



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA GJIROKASTER

**STUDIM PROJEKTIM PER OBJEKTIN:
“Sistemim - asfaltim rruga Taronine - Zhulat” L= 5 464 m”**

RAPORTI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NEMJEDIS

PROJEKT ZBATIMI

2024

SHOQERIA “ZENIT&CO”

Rruga Myrteza Topi, Ndertesa 18 Hyrja 7 Ap .38 Kodi Postar 1017. N Bash 9.

Tel 042278165

cel 0692099065

E-mail: zenit06@live.com

Tirane-Albania

1	HYRJE, KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI PROJEKTIN
2	KUADRI LIGJOR DHE METODOLOGJIA E NDJEKUR
2.1	Kuadri Ligjor Mjedisor dhe Institucional që Lidhet me Projektin.....
2.2	Qëllimi, objektivat dhe metodologjia e ndjekur për hartimin e VNM-së
3	PËRSHKRIM I GJENDJES SË MJEDISIT PRANË ZONËS SË PROJEKTIT
3.1	Klima
3.2	Kushtet Gjeologjike Inxhinierike te Zonës së Projektit
4	Raporti paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
4.1	Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti.....
4.2	Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij
4.3	Përshkrim i Zonave të Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës.....
5	VLERËSIM I NDIKIMEVE NEGATIVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS NGA PROJEKTI
5.1	Identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit (përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër dhe shëndet)
5.2	Shkarkimet në mjedis nga ndërtimi dhe zhvillimi i projektit.....
5.3	Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar.....
5.4	Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të
5.5	Mundësitë mbi rehabilitimin e mjedisit të ndikuar nga projekti
5.6	Masat e Mundshme për Shmangien dhe Zbutjen e Ndikimeve Negative në Mjedis
5.7	Impakt në burimet ujore
5.8	Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar.....
6	PROGRAM MONITORIMI
6.1	Qëllimet e monitorimit mjedisor.....
7	VLERËSIM I NDIKIMEVE POZITIVE QË MUND TË SJELLË ZHVILLIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR
8	KONKLUSIONE.....
9	REFERENCAT

1 HYRJE, KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI PROJEKTIN

Nisur nga nevoja e permiresimit sa me te shpejte dhe efikas te infrastruktures rrugore, Bashkia Gjirokaster ka iniciuar projektin "Sistemim - asfaltim rruga Taronine - Zhulat" L= 5 464 m", Gjirokastra eshte qytet ne Shqiperine Jugore . Qyteti eshte i përfshirë në Listën e Trashegimisë Botërore të UNESCO - s me 2005 , si një nga pak shembujt e mbijetuar në Ballkan të qyteteve tregtare të stilit otoman.

Gjirokastra eshte e vendosur në faqen e Malit te Gjerë dhe qëndron në shpatet e pjerrëta të luginës së lumit Drino , në një pozicion mbizotërues mbi një peizazh te pasur , kufijte e te cilit përvijohen nga maja malesh te larta . Ky është " qyteti i një mijë shkallëve " qe përfshin qindra shtëpi - kullë të tipit otoman me çatite dalluese të gurta , ballkonet e drunjta dhe muret e gurta hero here te zbardhura me gëlqere . Shtëpitë karakteristike dhe arkitektura e veçantë i japin asaj pamjen e një anije në luginën e Drinos , e sunduar nga ana e vet prej kalase madheshtore qe ngrihet mbi një koder të thikte. Gjirokastra është një qytet magjik me një të shkuar të trazuar . Arkitektura e ndërtesave historike ne gjirokastër , si dhe vetë qyteti i vjeter , është produkt shumë përbërësve . Relievi i thyer ka ndikuar në përcaktimin e vendosjes dhe mënyrën e shtrirjes së qyteti , që u krijua dhe u rrit ne kurrizet e 8 kodrave , nën hijen e kalase . Nga ana tjetër , afërsia e burimeve , prej ku sigurohej guri i nevojshëm për rrugët , muret dhe çatille , mundesoi pamjen e veçantë që ka qyteti . Rrëza dhe faqja e malit ku ndodhet është pothuajse e zhveshur pa bimësi . Gjirokastra ka klime mesdhetare . Ajo karakterizohet nga nje vere e nxehte dhe e thate si dhe nje dimer lagesht , jo shume i flohte . Temperatura mesatare vjetore e zones eshte rreth 14 grade , ndersa reshjet vjetore jane rreth 1700 mm shi , karakteristike per zonen eshte temperaturat maksimale dhe minimale , si dhe shperndarja jouniforme e reshjeve gjate vitit , ku pjesa me e madhe e tyre bie ne periudhen Nentor - Mars . Duke qenë e tille.ne dimer kur rreshjet skane te reshtur , neper pjerresi vershojnë përrenj të rrëmbyer me ujëra të shumta . Ato vijnë deri në qytet . Vetë qyteti ka shumë përrenj dhe çdo lagje ndahet nga njëra tjetra me një të tillë . Gjirokastra ka qenë dhe vazhdon të mbetet një nga qytet me me shume burime ujore.



Figure-1:Gjurma e aksit rrugor GJIROKASTER (gjurma projekti)

2 KUADRI LIGJOR DHE METODOLOGJIA E NDJEKUR

2.1 Kuadri Ligjor Mjedisor dhe Institucional që Lidhet me Projektin

Kuadri ligjor për Mbrojtjen e Mjedisit në Republikën e Shqipërisë është në përputhje me standardet e BE-së.

Ky projekt do të implementohet në territorin e Bashkisë Gjirokaster.

Në bazë të ligjit nr. 10440 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” ;neni 8, ky projekt kërkon “Vlerësim Paraprak Të Ndikimit në Mjedis ” ,*sipas shtojcës 2; pika 10/ gërma(d): “Ndërtim rrugësh, portesh dhe instalimesh për porte, duke përfshirë dhe portet e peshkimit (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I).*

Legjislacioni Shqiptar përcakton strukturën e përmbajtjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis që të jetë sa më konciz në informacionin që duhet të përfshijë sipas VKM 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.

Ligji Nr. 10431 datë 10.03.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”. Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Përmbledhja e kuadrit ligjor dhe institucional:

Legjislacioni mjedisor është ndërtuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Kështu, ndër më specifiket që lidhen me projektin përmendim:

Tabela-1:Përmbledhje e kuadrit ligjor mjedisor

Kuadri Ligjor	
Ligji Nr.10 431 datë 9.6.2011	Për mbrojtjen e Mjedisit
Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis
Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011	Për lejet e mjedisit
Ligji Nr.9362, datë 24.03.2005	Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve
Ligj nr. 10463 dt. 22.09.2011	Për menaxhimin e integruar të mbetjeve
Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006	Për mbrojtjen e biodiversitetit
Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002	Për zonat e mbrojtura I ndryshuar me: - Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008
Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007	Për administrimin e zhurmës në mjedis

Ligji Nr. 107/2014, datë 31.7.2014	“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar me Ligjin Nr. 73/2015, datë 09.7.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”
Në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë janë miratuar edhe disa ligje në kuadër të përfshirjes së vendit tonë në Protokolle dhe Marrëveshje të ndryshme. Ndër to përmendim	
Ligji Nr. 9672, datë 26.10.2000	Për ratifikimin e konventës së Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe përfshirjen në

	vendimmarrje, si dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”.
Ligji Nr. 9334, datë 16.12.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos në konventën për ndryshimet klimatike (UNFC).
Ligji Nr. 9048, datë 07.04.2003	“Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar. Ky ligj ka për qëllim shpalljen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë
Vendime të Këshillit të Ministrave	
VKM Nr 714 date 06.11.2019	“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e këshillit të ministrave nr. 686, datë 29.7.2015 ‘për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore’”, të ndryshuar
VKM 686, datë 29.7.2015	Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”
VKM Nr. 912, datë 11.11.2015	“ Për Miratimin E Metodologjisë Kombëtare Të Procesit Të Vlerësimit Të Ndikimit Në Mjedis”
VKM Nr. 587, datë 7.07.2010	Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike.
VKM Nr. 676, datë 20.12.2002	Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror
VKM Nr.804, datë 4.11.2003	Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihen në mbrojtje.
VKM Nr. 177, datë 31.3.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse.
VKM Nr.435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë.
VKM Nr.803, datë 4.12.2003	Për standardet e cilësisë së ajrit.
VKM Nr.994, datë 02.07.2008	Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin.
VKM Nr. 271, datë 6.4.2016	“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar.
VKM Nr. 408, datë 13.5.2015	“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”
VKM. Nr. 671, datë 29.7.2015	“Për miratimin e rregullores së planifikimit të

	territorit”
VKM Nr. 502, datë 13.7.2011	“Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit
Udhëzime dhe Rregullore	
Udhëzimi Nr. 1037/1, datë 12.04.2011	Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore
Udhëzimi Nr. 8, datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527, datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre.

2.2 Qëllimi, objektivat dhe metodologjia e ndjekur për hartimin e VNM-së

2.2.1 Qëllimi dhe Objektivat e VNM-së

Objektivi kryesor i hartimit të VNM-së është të identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore gjatë zhvillimit të projektit duke marrë në konsideratë:

- Analizën e alternativave dhe ndikimet mjedisore shoqëruese;
- Të sigurohet që burimet janë përdorur si duhet dhe në mënyrë eficientë;
- Të identifikohen masat e duhura për zbutjen e ndikimeve të mundshme të propozimit;
- Të vendosen kushtet për ndërtimin;

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit të Mjedis bazuar në qëllimin e projektit është hartuar:

- Të japë informacion mbi vendndodhjen e sheshit të projektit dhe të analizojë tiparet mjedisore;
- Të japë informacion mbi projektin teknik, për fazën parapregaditore, të ndërtimit dhe rehabilitimit.
- Të vlerësojë ndikimet e mundshme në mjedisin përreth dhe në banorët e zones ku do zhvillohet projekti.
- Të përshkruajë masat për reduktimin apo evitimin e impakteve të analizuara;
- Të hartojë planin për monitorimin e mjedisit për të mbajtur nën kontroll ndikimet
- Të informojë institucionet vendore, komunitetin dhe grupet e tjera të interesit për zhvillimin e projektit;
- Të nxjerrë konkluzione dhe rekomandime mbi rëndësinë e projektit në lidhje me ndikimet negative dhe pozitive si dhe rëndësinë sociale të tij.

Objektivat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshijnë përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejt mjedisore gjatë zbatimit apo mos zbatimit të projektit.

Ndikimet mjedisore të projektit janë vlerësuar në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e implementimit të projektit referuar projektit teknik të ndërtimit të këtij objekti.

2.2.2 Metodologjia e ndjekur për hartimin e VNM-së

Hartimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është bazuar referuar VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.

Aspektet më të rëndësishme të procesit paraprak të VNM-së janë identifikimi i ndikimeve që mund të shkaktojë projekti, konsultimet me palët e tjera të interesuara/të ndikuara dhe vendimi, nëse kërkohet një VNM e thelluar për projektin e propozuar.

Duke pasur si qëllim kryesor vendimmarrje më të mira, për të vendosur për nevojën e VNM-së (paraprake ose të thelluar), për informacionin e nevojshëm që duhet të përfshihet në raportin e VNM-së, si dhe raporte VNM-je të cilësisë së lartë, është e nevojshme të kalohet, së pari, nëpërmjet Listës së Kontrollit të Klasifikimit (Shoshitje - Screening Checklist).

3.1 Klima

Sipas klasifikimit klimatik të vendit tonë zona në studim luginë e Drinosit hyn në nënzonën klimatike mesdhetare kodrinore jug-lindore me drejtim veri-perëndimor-jug-lindor i nënshtrohet në mënyrë aktive ndikimit të detit Adriatik dhe më pak atij Jonian. Këtë drejtim ka dhe qarkullimi i erërave gjatë vitit. Në gjysmën e ftohtë mbizotëron jug-lindja dhe në gjysmën tjetër veri-perëndimi. Vendmatjet meteorologjike – Gjirokastra 193 m, Goranxia 210 m dhe Jorgucati 243m mbi nivelin e detit.




Figure.-2:Harta e Zonave Klimatike te Republikes se Shqiperise

Muaji më i ftohtë i vitit është janari ku temperaturat mesatare mujore në Gjirokastër janë 5.40 C dhe në Goranxi 5.30 C. Muaji më i nxehtë në zonat në studim është korriku më temperatura mesatare mujore 23.50 C dhe 23.00 C. Numri i ditëve të akullta (për temperaturën nën zero gradë) është për vendmatjet meteorologjike Gjirokastër 46.2 ditë në vit ndërsa për Goranxinë është 47.4. Ndërsa numri i ditëve me temperatura nën -5.00 C është respektivisht 5.4 Gjirokastër dhe 2.3 Goranxi. Siç shikohet në zonën në studim kemi një uniformë të elementit temperaturë të ajrit – të mesatareve dhe të ekstremeve të

temperaturës.

3.2 Kushtet Gjeologjike Inxhinierike te Zonës së Projektit

Zona jonë e studimit bën pjesë në zonën Jonike, nënzonën e Kurveleshit. Në zonën në studim takojmë depozitimet e mëposhtme:

Paleoceni (Pg1)

Në zonën Jonike depozitimet e Paleocenit vijnë normalisht mbi ato të Kretakut të sipërm dhe përhapen në sipërfaqe në të gjitha strukturat karbonatike. Litologjikisht përfaqësohen nga gëlqerorë turbiditike, masive të ndërthurur me gëlqerorë pllakorë mikritike e mikroshpatike, me ngjyrë të bardhë. Midis tyre takohen thjerza e konkrecione silicoresh të rrallë. Nga ana litologjike këto depozitime janë të ngjashme me ato të Maastrikianit, ndaj dhe është vështirë ndjekja në terren e këtij kufiri. Karakteristike është prania e një horizonti vithisës nënujor në këto depozitime, i cili në struktura të veçanta, sidomos në pjesën qëndrore të zonës Jonike shoqërohet edhe nga horizonte të tjerë. Trashësia e depozitimeve paleocenike varion nga 30-40 m (GorishtBallsh), 55m. (prerja e m.Gjerë) deri 100-120m. në strukturat e nënzonës së Beratit.

Eoceni (Pg2)

Këto depozitime përhapen në sipërfaqe në të gjitha strukturat karbonatike të zonës Jonike duke marrë pjesë në ndërtimin e krahëve dhe zhytjeve periklinalë të tyre. Depozitimet e Eocenit vijnë normalisht mbi ato të Paleocenit, duke ruajtur në pjesën e poshtme të tyre karakteristika të njëjta litologjike. Kështu, në fillim të prerjes vazhdojnë gëlqerorë turbiditike, që gradualisht ja lënë vendin gëlqerorëve shtresore biomikritike e mikritike, me përmbajtje argjilash mergelore të cilat në pjesën më të sipërme predominojnë duke kaluar në mergelet e “pakos kalimtare”. Trashësia e depozitimeve të Eocenit për zonën Jonike varion nga rreth 100 m në prerjen e m.Gjerë, Kremenare, etj. deri në rreth 200 m në Këlcyrë, Dukat, Fterre, etj

Oligoceni i poshtëm (Pg3 1)

Depozitimet e Oligocenit të poshtëm në sipërfaqe përhapen pothuajse në gjithë zonën Jonike, duke marrë pjesë në ndërtimin e krahëve dhe periklinalëve të strukturave brenda vargjeve antiklinale e sinklinale. Kalimi për në depozitimet flishore bëhet nëpërmjet pakos mergelore kalimtare. Kjo pako përfaqësohet nga dy paketa: e poshtmeja e karakterizuar nga mergele me shtresa gëlqerorësh biomikritik (5-10cm.), ndërsa e sipërmeja përfaqësohet nga argjila mergelore dhe argjila ngjyrë të kaltërt rrallë me ndonjë shtresë gëlqerori. Në përfundim të nënzonës së Beratit, në Kurvelesh dhe Çike takohen dhe argjila shumë-ngjyrëshe. Këto depozitime kudo vendosen normalisht mbi shkëmbinjtë karbonatikë të Eocenit të sipërm. Vetëm në një vend, në pjesën veriore

të antiklinalit të Çikes (shtegu i Dhive), pakoja mergelore kalimtare vendoset me mospërputhje të theksuar stratigrafike mbi gëlqerorët algore të Liasit të poshtëm-të mesëm (Dalipi, etj. 1978). Më sipër me fillimin e shtresës së parë ranorike prerja vijon me ndërthurje argjilo-alevrolito-ranore dhe ranoro-alevrolito-argjilore ritem hollë e rrallë ritem mesëm. Këto depozitime pësojnë ndryshime litologjike të theksuara në hapësirë si në vertikalisht dhe në drejtim horizontal. Kështu në nënzonën e Beratit ato përfaqësohen nga flishi i ashpër me vidhisje nënujore të shumta, të shoqëruara me olistolite gëlqerorësh me përmasa deri 200m-300m. Kjo dukuri ndodh kryesisht në jug-lindje të sinklinalit të Përmetit. Në drejtim të veriut numri i vidhisjeve nënujore dhe shtresave gëlqerore zvogëlohet deri në shuarje (prerja e Beratit, Shehu H., etj. 1972,1987). Në nënzonën e Kurveleshit e më në përfundim, mbi depozitimet e flishit të hollë argjilo-ranor vijon normalisht flishi argjiloranor, me shtresa gëlqerorësh ritem hollë-mesëm (prerjet e Kremenares, Sopikut, Sarandës etj.). Në pjesën veriore të nënzonës së Çikes (prerja e Lapardhasë) kjo trashësi kryesisht përfaqësohet nga ndërthurje argjilash me shtresa gëlqerori. Nga studimet e përcaktimet petrografiko-mineralogjike në depozitimet e Oligocenit poshtëm janë veçuar

zonat: Kuarcore dhe Kuarcoro-Serpentinike.Trashësia e depozitimeve të Oligocenit poshtëm në zonën Jonike zvogëlohet nga lindja (prerja e Këlcyrës 1750m) në perëndim (prerja e Lapardhasë 80m) dhe nga jugu (prerja e Këlcyrës 1750m) në veri (preja e Beratit 840m) dhe nga 1100m në Llongo (m. i Gjerë) në 400m. Kremenare (Shehu H., etj. 1979).

Oligoceni i mesëm (Pg3 2)

Depozitimet e Oligocenit të mesëm takohen në të tre nënzonat tektonike (Beratit, Kurveleshit dhe Çikes), duke marrë pjesë në ndërtimin e krahëve të strukturave antiklinale dhe sinklinale.Në rajonet e pjesës qëndrore të zonës Jonike këto depozitime përfaqësohen nga flish argjilo-ranor kryesisht ritem mesëm me shtresa gëlqerori mikritik, biomikritik e turbiditik. Karakteristikë dalluese është rritja e shtresave gëlqerore nga lindja në perëndim, jo vetëm si numër por edhe si trashësi, dhe zvogëlimi i komponentit ranor, deri në zhdukje të tij perja e Lapardhasë (antiklinali i Tragjasit). Ndërsa në nënzonën lindore të zonës Jonike këto depozitime përfaqësohen nga flish ranoro-argjilor me vithisje nënujore e me shtresa të rralla gëlqerorësh.Depozitimet e Oligocenit mesëm nga ana petrografike përfshihen në zonat kuarcoro-serpentinike (Q+S) dhe pjesa e sipërme e tyre në zonën Kuarcoro-Kuarcitike. Trashësia e depozitimeve të Oligocenit të mesëm zvogëlohet nga lindja në perëndim, konkretisht në nënzonën e Beratit është rreth 700m., ndërsa në atë të Çikes 130m. (prerja e Lapardhasë) e njëjta ligjësi vërehet edhe nga veriu në jug për të gjitha nënzonat tektonike.

Oligoceni i sipërm (Pg3 3)

Depozitimet e Oligocenit të sipërm kanë përhapje më të kufizuar në krahasim me ato të Oligocenit të poshtëm dhe të mesëm. Ato marrin pjesë në ndërtimin e vargjeve sinklinale dhe vazhdimeve veriore të nënzoneve të Beratit dhe Kurveleshit. Në pjesën lindore, në vargun sinklinal të Përmetit përfaqësohen nga ndërthurje argjiloalevrolito-ranore, me ranore masive, vidhisje nënujore dhe më rrallë shtresa gëlqerorësh. Më në perëndim, duke filluar nga vargu sinklinal i Memaliajt e më në perëndim vërehet prania e bollshme e shtresave të gëlqerorëve biomikritike. Në përgjithësi të gjithë shtresat gëlqerore nëtavan kalojnë gradualisht në mergele argjilore. Nga lindja në perëndim vërehet dhe rritja e numrit të horizonteve vithisës. Në përgjithësi në pjesën e sipërme të Oligocenit të sipërm predominojnë ranorët të cilët hera-herës kalojnë në ranorë masive. Në buzën lindore të vargut sinklinal të Memaliajt dhe në vazhdimin verior të nënzonës së Kurveleshit (në veri të antiklinalit të Gribës), këto depozitime janë të reduktuara dhe përfaqësohen nga flish argjilor që i përket formacionit "Sefaj".Pra, siç shihet depozitimet e Oligocenit të sipërm pësojnë ndryshime të theksuara nga lindja në perëndim dhe nga jugu në veri. Në përgjithësi në zonën Jonike këto depozitime në sipërfaqe kanë marrëdhënie pajtuese me depozitimet e mëposhtme të Oligocenit të mesëm.Trashësia e depozitimeve të Oligocenit sipërm luhetet nga 1140m. në lindje (prerja e Beratit), në 390m. në perëndim (prerja e Lapardhasë-Vlorë). E njëjta ligjësi vërehet edhe nga veriu në jug.

Holoceni (Qh)

Depozitimet e Holocenit kanë përhapje të gjerë në Shqipëri. Në këtë seksion takohen pothuaj të gjitha tipet gjenetike si ato kontinentale, ato ndërmjetëse dhe ato detare. Më të përhapura janë depozitimet aluviale, të cilat kanë mbushur pothuaj tërësisht Ultësirën Adriatike nga Mbishkodra deri në afërsi të Vlorës. Përhapje të konsiderueshme kanë edhe tipet e tjerë gjenetikë, si ato pruluviale, eluviale e deluviale, kënetore e liqenore, lagunore e detare, të cilat më poshtë do të përshkruajmë më hollësisht. Seksioni i Holocenit çdo ditë e më tepër po detajohet dhe po ndahet në dy kate, në Holocenin e hershëm dhe në Holocenin e vonshëm që shpesh emërtohet dhe si Holoceni historik. Këtë emërtim e ka marrë nga qënë këtë kat ka filluar të dallohen edhe gjurmët e qytetërimit njerëzor.Në vendin tonë nga punimet e fundit janë veçuar formacione të Holocenit të hershëm nëpërmjet studimit të sporopoleneve dhe përcaktimit të moshës absolute dhe fosileve që do të trajtohen në kapitullin përkatës si dhe Holocenin e vonshëm, (historik) kryesisht i bazuar në të dhënat arkeologjike. Pavarësisht nga të dhënat e fituara, Holoceni do të trajtohet i pa ndarë.

Depozitimet aluviale

Ato kanë përhapje të gjerë në zonat e ulta, në rrjedhjet e mesme të lumenjeve, shpesh edhe në rrjedhjet e sipërme. Në rrjedhjet e mesme dhe të sipërme ato formojnë depozitimet e teracave të shtratit si dhe depozitimet e sotme të shtratit, të cilat i perkasin Holocenit të vonshëm. Këto depozitime kanë qënë dhe janë objekt i shfrytëzimit të inerteve, pasi kryesisht përfaqësohen nga zhavorre, zhurre dhe rëra. Këto depozitime i takojmë në të gjithë lumenjtë tanë. Përhapjen më të madhe depozitimet aluviale e kanë në fushat e Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Lushnjes e Vlorës, fushës së Korçës e Bilishtit, të fushës së Dropullit, të fushës së Vurgut e tjera, të cilat kanë marrë edhe emërtimin fushat aluviale(kryesisht zhavorre).




Figure.-3:Harta Gjeologjike e Republikës së Shqipërisë

3.2.3 Rreziku Sizmik

Bazuar mbi Hartën e Rajonizimit Sizmik të vitit 1979, zona jonë e studimit bën pjesë në zonën me intensitet të pritshëm të lëkundjes sizmike prej VI dhe VII ballë sipas shkallës MSK - 1964



Figure.-4:Harta e Zonave Sizmike te Republikes se Shqiperise

3.2.4 Hidrologjia

Përshkrim i përgjithshëm i hidrologjisë së rajonit të projekti

Lugina ne studim karakterizohet nga nje rrjet hidrografik ne te dy shpatet e lugines, kryesisht i llojit rreke dhe proske.

Vecorite hidrologjike

Lugina e Drinosit ku vendoset qyteti i Gjirokastrës pershkohet nga lumi me te njejtin emer, Drino, (dege e Vjoses). Ky lum kalon ne një pjese e cila eshte mjaft e gjere dhe krejt e rrafshet që është pjesa e sipërme e kësja lugine. Ajo ka toka shume te mira bujqesore. Ne pjesen e poshtme ngushtohet dhe rritet pjerresia e shpateve.

Ndersa lumi i Vjoses me te cilin bashkohet ky lum, ka nje siperfaqe ujembledhese prej 6.706 km², 2.154 km² prej të cilave gjenden brenda kufijve të Greqisë, dhe 4552 km² brenda kufijve të Shqipërisë. Prurja mesatare e ujrave në grykëderdhje është rreth 204 m³/s. Në muajin Prill prurja është rreth dhjetë herë më e madhe se në Gusht. Lumi Vjosa, rrjedha e të cilit përshkon jugun e Shqipërisë, është dhe kufiri ndarës natyror midis rrethit të Fierit (në veri) dhe rrethit të Vlorës. Ai është një lum i lundrueshëm, pasi ai rrjedh kryesisht në zona fushore.

Në rrjetin hidrografik të Gjirokastrës spikat dhe Liqeni i Viroit, i cili ndodhet rreth 5 km larg larg tij, në krah të rrugës nacionale, kur shkon për në Tepelenë. Viroi është një liqen artificial që ushqehet me ujrata që burojnë me vrull nga “Mema”, një burim shumë i thellë, me natyrë karstike, me ujë të kulluar e të pastër. Mendohet se uji i Viroit vjen nga shpella me natyrë karstike e Skotinisë, që ndodhet në fshatin Vanistër në jug të Gjirokastrës, një vend pelegrinazhi dhe njëherësh turistik. Përreth liqenit shpaloet një peizazh i mrekullueshëm i kodrave të gjelbëruara përreth. Viroi është një vend për piknik, për çlodhje, për të eksploruar natyrën nga të apasionuarit e natyrës, studiuesit ose nxënësit e shkollave. Gjithashtu tashmë vizitohet edhe nga shumë turistë të huaj, që vijnë në qytet.

Faza ndertimore

Masat e kontrollit te ndotjes do te vendosen ne vend gjate procesit te ndertimit. Kjo do te perfshije pajisjen e skelave dhe gardhimet prej balte.

Rezervat e materialeve te ndertimit, si asfalti, vaji dhe kimikatet nuk do te vendosen afer asnje siperfaqeje te vijave ujore, apo puse uji. Rezervat do te vendosen ne siperfaqe te mbyllura, te mbuluara me shtresa (carcarfe) mbyltese ose me nje cati me te qendrueshme ose e rrethuar nga nje porte per te parandaluar humbjeve. Rezervat do te mbrohen per te parandaluar vandalizmin dhe vjedhjen qe mund te coje ne humbje.

Largimet nga vendndohjevet e shkaktuara nga aktivitetet e kantierit te ndertimit do te trajtohen ne perputhje me llojin e tyre. Uji qe vjen nga larja e makinave dhe nga pajisja, do te trajtohet me ane te sedimentimit ne nje rezervuar stabilizimi (funderrimash) per pjese te rendomta dhe nderprerje vajerash per te lejuar pjeset e vockla dhe vajerash qe te eliminohen. Uji qe vjen nga larja e agregateve dhe nga prodhimi I konglomerateve do te trajtohet me ane te sedimentimit ne rezervuare dhe pastaj te perdoret perseri ose te dergohet ne nje vend tjeter.

Temperatura e ajrit

Temperatura ajrit – një ndër elementët kryesorë në përcaktimin e veçorive klimatike të vendit tonë në regjimin e saj mesatar me ecurinë e saj vjetore e ditore si dhe me vlerat ekstreme ndikon në strukturat

ndërtimore.

Tabela 2. Mesatare të temperaturës së ajrit

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Mes
Gjirokaster	5.4	6.9	9.3	12.8	17.2	21.2	23.5	23.6	20.1	15.0	10.3	6.7	14.3

Tabela 3. Temperatura maksimale absolute e ajrit

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Gjirokaster	20.1	22.5	26.2	27.5	32.5	39.9	42.6	39.5	37.4	31.4	26.8	20.6	42.6

Tabela 4. Temperatura minimale absolute e ajrit

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Gjirokaster	-7.0	-6.4	-16.6	0.0	2.2	6.5	8.7	9.5	5.6	-1.5	-4.6	-17.4	-17.4




Figure.-5 Shpërndarja brendavjetore e temperaturave mesatare të ajrit në zonën në studim

Muaji më i ftohtë i vitit është janari ku temperaturat mesatare mujore në Gjirokastër janë 5.40 C dhe në Goranxi 5.30 C. Muaji më i nxehtë në zonat në studim është korriku më temperatura mesatare mujore

23.50 C dhe 23.00 C

Numri i ditëve të akullta (për temperaturën nën zero gradë) është për vendmatjet meteorologjike Gjirokastër 46.2 ditë në vit ndërsa për Goranxinë është 47.4. Ndërsa numri i ditëve me temperatura nën -5.00 C është respektivisht 5.4 Gjirokastër dhe 2.3 Goranxi. Siç shikohet në zonën në studim kemi një uniformë të elementit temperaturë të ajrit – të mesatareve dhe të ekstremeve të temperatures.

Rreshjet

Reshjet atmosferike janë një nga elementët më të rëndësishëm klimatik që përcaktojnë veçoritë klimatike të zonës. Në rastin e projektimit të një rruge, veçoritë e reshjeve atmosferike kanë një rol të rëndësishëm sepse kanë të bëjnë me projektimin e drenazhimit që lidhet direkt me mbrojtjen e rrugës dhe nga ana tjetër lidhet me kushtet e transportit të mjeteve lëvizëse.

Tabela 5. Reshjet mujore dhe vjetore

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Gjirokaster	281	237	168	119	77	34	20	32	94	196	324	346	1930

Tabela 6. Reshjet më të mëdha 24 orëshe mujore vjetore

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Gjirokaster	216	168	93	97	65	53	21	51	95	199	288	216	288

Tabela 7. Reshjet më të mëdha 24 orëshe me siguri të ndryshme

Vendmatja	Sigurite e ndryshme				
	1	2	5	10	20
Gjirokaster	349	314	267	231	193




Figure.-6 Shpërndarja brendavjetore e reshjeve atmosferike ne zonen e projektit

Reshjet mesatare shumëvjeçare në zonën në studim janë rreth 1800mm. Kjo tregon se kemi të bëjmë në një zonë me reshje të shumta dh të rrëmbyera. Në krahasim me vlerën mesatare të territorit shqiptar (1400mm) kjo zonë renditet ndër zonat më të lagëta të Shqipërisë. Siç tregohet në tabelën 6 dhe në grafikun në figurën 6 shpërndarja e reshjeve gjatë vitit ka një formë “U” që është tipike e një regjimi Mesdhetar të reshjeve sasia më e madhe pritet në periudhën e ftohtë të vitit dhe muajt më të lagët janë Nëntor-Dhjetor (Gjirokastra 324, 346) (Goranxi 301, 323). Muaji më i thatë është korriku (përkatësisht 20, 20mm/muaj). Duke patur parasysh sasinë maksimale për 24 orë të reshjeve dhe intensitetin për intervale të ndryshme kohe në periudha të ndryshme kthimi (return periods), kjo zonë karakterizohet nga një intensitet i lartë i reshjeve. Në vendmatjen meteorologjike Gjirokastrë sasia e reshjeve 24 orëshe arrin deri në 288mm në Goranxi 277mm dhe në Jorgucat 277mm




Figure-7:Shperndarja zonale e reshjeve ditore neper Shqiperi

4 RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

4.1 Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti

Flora e zones.

Tipet kryesore të habitateve Nder tipet kryesore të habitateve në zone përmendim: a) Pyjet aluvionale përgjate brigjeve të lumit b) Pyjet dhe shkorretat mesdhetare (formacionet e makjes) c) Toka bujqësore a) Pyjet aluvionale Brigjet e lumit të Drinos shpesh me shtrat të gjere janë të mbuluar me vegjetacion hidrohigrofil. Shoqerimet bimore kryesore të pyjeve aluvionale u perkasin klasave Alno-Populetea dhe Salicetea purpurea. Perberesit kryesore të pyjeve aluvionale të zallishteve të lumit të Drinit janë: *Platanus orientalis*, *Alnus incana*, *Populus alba*, *Salix alba*, *Salix purpurea*, *Salix amplexicaulis*, etj. Në ujërat me rrjedhje të shpejte marrin prioritet shoqerimet me *Platanus orientalis* apo të ashtuquajtura rrapishte. Krahas këtyre formacioneve të dominuara nga rrapit (*Platanus orientalis*) vihen re edhe formacione të dominuara nga *Populus alba*. Në katin shkurror të këtyre pyjeve verëhen llojet bimore: *Salix elaeagnos*, *Tamarix parviflora*, *Rubus ulmifolius*, *Crataegus monogyna*, *Rosa sempervirens*, *Vitex agnus castus* etj. Në ujërat me rrjedhje të qete, në mocalishte buze ujërave me substrat lymor dhe toka eutrofike marrin prioritet shoqerimet me *Alnus incana* (asociacioni *Alnetum-incanae*), *Alnus glutinosa*, *Salix alba*. Elemente dominante të këtyre shoqerimi janë *Alnus incana*, *Ulmus minor*, *Populus alba* dhe *Fraxinus ornus*. Gjithashtu në këto rrjedha janë të pranishme shoqerimet bimore të klases *Phragmitetalia* me asociacionin kryesor *Phragmites australis* si dhe shoqerimet bimore të shavarit (*Typha angustifolia*). Një asociacion i tillë tregon një plasticitet të larte ekologjik. b) Pyjet dhe shkorretat mesdhetare Brezi I pyjeve dhe shkorretave mesdhetare perfaqeson formacionin baze dhe me perhapjen me të madhe. Shoqerimi i *Quercetum cocciferii* formon formacionin shkurror të dominuar nga pralli. Shoqerimi i *ArbutoEricetum*, i marese me shqopen, është formacioni bimor me I perhapur në këto lugine. Formacione të pyjeve të *Quercus frainetto* e *Quercus cerris* si dhe stadeve të degradimit të tyre (*Carpinus orientalis*, *Ostrya carpinifolia*) takohen në një pjesë të konsiderueshme, deri në 1200 m lartësi mbi nivelin e detit, por rrallë herë në gjendje të mirë. Nga pikpamja fitosociologjike këto pyje i perkasin rendit *Quercetalia pubescentis* dhe aleancës *Quercion frainetto-cerris*, *OstryoCarpinion orientalis*. Pylli natyror dominohet kryesisht nga *Quercus cerris*, i shoqeruar nga *Quercus pubescens* apo *Quercus frainetto*. Edhe flora barishtore paraqitet e pasur në këto zone. Nder llojet me të pranishme të zones përmendim: *Origanum vulgare*, *Psoralea bituminosa*, *Trifolium campestre*, *Dorycnium pentaphyllum*, *Brachypodium ramosum*, *Campanula glomerata*, *Dictamnus albus*, *Micromeria Juliana*, *Micromeria graeca*, *Bellis perennis*, *Dactylis glomerata* etj. c) Tokat bujqësore Tokat bujqësore ndeshen përgjate pjesës me të madhe të rrugës. Në shumicën e rasteve kultivohet miser, grure, perime dhe peme frutore. Produktiviteti i tyre paraqitet i larte si rezultat i aluvioneve lumore.

Fauna e zones

Zona e projektit ka nje faune tipike te rajoneve rurale dhe antropogjenike si edhe te lidhur me habitatet e ndikuara nga veprimtaria e njeriut. Nga gjitaret, llojet me te hasura jane dhelpra (*Vulpes vulpes*) dhe lepuri i eger (*Lepus europaeus*), shenja te te cileve u identifikuan shpesh gjate vizitave ne terren. Gjithashtu ne zone hasen lloje te familjes se mustelideve si nuselala (*Mustela nivalis*), kunadhja (*Martes foina*) dhe baldosa (*Meles meles*) si edhe prania e mundshme e çakallit (*Canis aureus*). Nder gjitaret e vegjel te pranishem ne zone permendim ketrin (*Sciurus vulgaris*), iriqin (*Erinaceus concolor*), urithin (*Talpa caeca*), hundegjate (*Crocidura suaveolens*, *Crocidura leucodon*), gjerin e lajthise (*Muscardinus avellanarius*), dhe lloje te ndryshme minjsh (*Muridae*). Gjithashtu ne zone hasen disa lloje lakuriqesh nate. Bazuar ne pozicionin gjeografik te zones, kushtet klimatike, llojet e habitateve si edhe kerkimeve ne terren, llojet e gjitareve te zones se jane paraqitur ne tabelen e meposhtme:

Lloji	Prania	Emri shqip
RENDI INSECTIVORA		
Fam. Erinaceidae		
<i>Erinaceus concolor</i>	P	Iriqi
Fam. Talpidae		
<i>Talpa caeca</i>	P	Urithi i verber
Fam. Soricidae		
<i>Suncus etruscus</i>	?	Hundgjate i vogel dhembbebardhe
<i>Crocidura suaveolens</i>	P	Hundgjate i kopshteve
<i>Crocidura leucodon</i>	P	Hundgjate i livadheve
RENDI CHIROPTERA		
Fam. Rhinolophidae		
<i>Rhinolophus blasii</i>	P?	Lakuriq nate hund-patkua i Blausius-it
<i>Rhinolophus euryale</i>	P?	Lakuriq nate hund-patkua i Mesdheut
<i>Rhinolophus ferrumequinum</i>	P?	Lakuriq nate hund-patkua i madh
<i>Rhinolophus hipposideros</i>	?	Lakuriq nate hund-patkua i vogel
Fam. Vespertilionidae		
<i>Miniopterus schreibersi</i>	P?	Lakuriq nate i Schreiber-it
<i>Myotis blythi</i>	P	Lakuriq nate vesh miu i vogel
<i>Myotis myotis</i>	P	Lakuriq nate vesh miu i madh
<i>Myotis mystacinus</i>	P?	Lakuriq nate me mustaqe
<i>Nyctalus leisleri</i>	P?	Lakuriq nate i Leisler-it
<i>Nyctalus noctula</i>	P?	Noktule
<i>Pipistrellus pipistrellus</i>	P	Lakuriq nate i zakonshem
<i>Plecotus auritus</i>	P?	Lakuriq nate veshegjate i zakonshem
<i>Plecotus austriacus</i>	P?	Lakuriq nate vesh-gjate i hirte
RENDI LAGOMORPHA		

Fam. Leporidae		
<i>Lepus europaeus</i>	P	Lepur i murme
Fam. Sciuridae		
<i>Sciurus vulgaris</i>	P	Ketri
Fam. Gliridae		
<i>Muscardinus avellanarius</i>	P	Gjumashi i lajthise
Fam. Muridae		
Microtinae		
<i>Arvicola terrestris</i>	?	Miu i ujrave
<i>Microtus felteni</i>	P?	Miu i Felten-it
<i>Microtus thomasi</i>	P?	Miu i lajthise
Murinae		
<i>Apodemus flavicollis</i>	?	Miu i ujrave
<i>Apodemus mystacinus</i>	P?	Miu i shkembit
<i>Apodemus sylvaticus</i>	P?	Miu bisht-gjate
<i>Micromys minutus</i>	P	Miu i te korrave
<i>Mus musculus</i>	P	Miu i shtepise
<i>Mus spicilegus</i>	P	Miu i stepes
<i>Rattus norvegicus</i>	P	Miu i murrme i kanaleve
<i>Rattus rattus</i>	P	Miu i zi i kanaleve
RENDI CARNIVORA-		
FISSIPEDIA		
Fam. Canidae		
<i>Canis lupus</i>	0	Ujku
<i>Canis aureus</i>	P	Cakalli
<i>Vulpes vulpes</i>	P	Dhelpra
Fam. Mustelidae		
<i>Lutra lutra</i>	P?	Lunderza
<i>Meles meles</i>	P	Baldosa
<i>Mustela nivalis</i>	P	Nuse lale
<i>Mustela putorius</i>	?	Qelbesi
<i>Martes foina</i>	P	Kunadhja

P- i pranishem; P?- potencialisht i pranishem; ? - prania e dyshimte; 0 - lloj rastesor.

Shpendet e pranishem ne zone jane lloje tipike te habitateve rurale dhe peizazheve antropogjenike. Me te zakonshmit jane shpendet e rendit te harabeloreve (Passeridae) si harabeli i shtepise (*Passer domesticus*), gardalinat (*Carduelis chloris*, *Carduelis carduelis*), sorra (*Corvus corone*), laraska (*Pica pica*), mellenjat (*Turdus sp.*), bishtatundesit (*Motacilla sp.*). Gjithashtu, me shumice haset kumria (*Streptopelia decaocto*)

dhe nder llojet veruese qyqja (*Cuculus canoris*) dhe pupeza (*Upupa epops*). Llojet grabitqare jane pergjithesisht te rralle, nder te cilet haset huta e zakonshme (*Buteo buteo*) dhe kukuvajka (*Athene noctua*). Nga herpetofauna, llojet me te zakonshme jane breshkat e tokes (*Testudo hermanni*), hardhuca (*Podarcis muralis*), bullari (*Pseudopus apodus*), gjarpri i ujit (*Natrix natrix*) dhe lloje te ndryshme bretkosash (*Rana* sp.)

4.2 Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij

Nje numer i rrjedhave natyrore, veçanerisht ato prane zones urbane, jane degraduar kryesisht per shkak te bujqesise intensive dhe te zhvillimit urban. Megjithate, bimesia bregor eshte e mirembajtur duke sherbyer si korridore natyrore duke siguruar vendbanim te rendesishem natyror per speciet lokale (shpendeve, zvarraniket dhe amfibet). Ne zonat me rurale te rruges shkalla e degradimit te ujit eshte e ulet ne disa raste eshte tranzitore. Megjithate, ne shume pjese integriteti natyror i korridorit uJOR eshte kryesisht i paprekur duke reflektuar nje cilesi ndryshe te habitait aty. Cilesia e mjedist ne kete zone ka mundesi te medha per tu ruajtur dhe zhvilluar ne te ardhmen. Ndikimet pozitive qe ky projekt do te sjelle per zonen do te nxise pervec te tjerash edhe angazhimin afatgjate te qeverisjes vendore apo OJF te ndryshme per rritjen e nivelit te edukimit mjedisor ne aspekte te ndryshme si menaxhimi i mbetjeve, menaxhimi i biodiversitetit etj.

4.2.1 Burimet e ujit të pijshëm në zonën e projektit

Në gjumrën e projektit dhe në afërsi me të nuk ka burime të ujit të pijshëm

Nuk ka asnje burim i ujit të pijshem në afërsi me zonën e projektit i cili do mund të ndikohet nga faza ndërtimore apo më pas.

4.3 Përshkrim i Zonave të Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës

Rrjeti i Zonave të Mbrojtura, brenda Shqipërisë, përmban disa kategori, të cilat mund të përcaktohen si më poshtë:

Kategoria I: Rezerva Vetëm për qëllime Natyrore/ Rezerva për qëllime

Shkencore Kategoria II: Park Kombëtar

Kategoria III: Monument Natyror

Kategoria IV: Rezerva Natyrore të Administruara/Zonë e Administruar e Specieve dhe Habitave Kategoria V: Zonë Peisazhi e Mbrojtur

Kategoria VI: Zonë e Mbrojtur për Shumë Përdorime.

Referuar Hartës së Zonave të Mbrojtura të publikuar nga AKZM (http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=item&layout=item&id=68&Itemid=368&lang=en), rezulton se zona e projektit nuk ndërpret zona të mbrojtura dhe monumente të natyrës.



Figure-9:Harta e zonave të mbrojtura Shqipëtare

5 VLERËSIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS NGA PROJEKTI

5.1 Identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit (përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër dhe shëndet)

“Sistemim - asfaltim rruga Taronine - Zhulat” L= 5 464 m”, ashtu sikurse edhe aktivitetet e tjera ndërtimore qe zhvillohet në mjedis shoqërohet me impakte pozitive dhe negative që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria ka zgjedhur për t’u zhvilluar.

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme në mjedis i projektit të propozuar është gjykuar mbi faktorët që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e funksionimit, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha nën kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis është analizuar sipas fazave të veprimtarisë si më poshtë: Sipas natyrës ndikimet klasifikohen në dy grupe të mëdha:

- Ndikime të kthyeshme;
- Ndikime të pakthyeshme;

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relativë ku qëllimi kryesor është

mbajtja e ndikimit brenda sipërfaqes së çdo objekti dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizim të proceseve komplekse të natyrës dhe rigjenerim të biodiversitetit.

Vetë natyra e aktivitetit të propozuar dikton ndikime dhe efekte të përhershme ose ndikime mbetëse në karakterin e mjedisit të sapokrijuar përgjatë gjithë tërësisë së tij, për zbutjen e të cilave propozohen masa konkrete.

5.1.1 Metodat e Zbatuara për Parashikimin e Ndikimeve Negative në Mjedis

Zgjedhja e metodës për parashikimin e ndikimeve negative në mjedis për fazën ndërtimore dhe afatgjatë të

zhvillimit të projekti është bazuar në projektin teknik për **“Sistemim - asfaltim rruga Taronine - Zhulat” L= 5 464 m**”, vendodhjes së gjurmës së projektit, kohëzgjatjen e fazës ndërtimore, gjendjen aktuale të cilësisë së mjedisit përreth zonës së projektit, ndikimin social për shkak të shpronësimeve si dhe duke u bazuar në ndikimet pozitive afatgjatë për zonën e projektit, vecanërisht për vlerat turistike të zonës. Për të vlerësuar ndikimet e pritshme në mjedis grupi hartues është bazuar në:

- Krijimin e një baze të dhënash me përgjigjet mbi pyetjet lidhur me problematikat mjedisore dhe analizimin e tyre;
- Analizimin e zbatimit të projektit;
- Përputhshmëria e plotë projekti me ligjet dhe rregulloret përkatëse;
- Ndikimi nga projekti në kushtet sociale-ekonomike të komunitetit pritës dhe shëndeti i banorëve;
- Ndikimet afatgjatë ose të përhershëm në sistemet ekologjike ose pasuritë natyrore të lokalitetit apo ato që paraqesin interes kombëtar ose rajonal?
- Vlerësimi nëse do të ndikohen komponentët e ndryshëm të ekosistemit të zonës?

Analizimi i zbatimit të projektit:

Kjo merr në konsideratë pajisjet, makineritë, lëndët ndihmëse, mënyrën e implementimit të projektit, kohën, afatet dhe ekipin e nevojshëm për realizimin e tij.

Faktorët dhe Kriteret që zbatohen në Vlerësimin e Ndikimeve të Mundshme

Për të përcaktuar nëse një ndikim negativ në mjedis, gjatë zbatimit të projektit, duhet të reduktohet apo të zbutet, jemi bazuar në vlerësimin e një ose më shumë nga faktorët e mëposhtëm:

- Krahasimi me ligjet, rregulloret apo me standardet e pranuar (kombëtare dhe udhëzimet dhe standardet ndërkombëtare)
- Konsultimi me vendimmarrësit përkatës dhe me agjencitë e mjedisit, etj.
- Preferencë të kritereve të paravendosura, si zonat e mbrojtura apo zona me ndjeshmëri të lartë mjedisore;
- Përputhshmëria me objektivat e politikave qeveritare si dhe planet e përgjithshme vendore të bashkisë Gjirokaster;
- Mbledhja e sa më shumë informacioneve dhe njohurive lidhur me temën e projektit, nivel sa më i lartë dhe një gjykim sa më të mirë profesional të ekipit të që harton vlerësimin mjedisor
- Njohje dhe vlerësim më të mirë të vlerave të ekosistemit.

5.1.2 Vlerësimi i Ndikimeve në Mjedis

Në mënyrë të përgjithshme gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis për zhvillimin e këtij projekti janë

analizuar ndikime potenciale negative të në mjedis për indikatorët mjedisorë dhe social në vijim :

- Impakt në tokë/tjëtërsim të tokës bujqësore
- Impakt në burimet ujore
- Impakt në cilësinë e ajrit
- Ndikimi në Biodiversitetin e zonës së projektit
- Ndikimi vizual
- Zhurmat
- Impakti në Trafikun Rrugor
- Impakti në Trashegimë Kulturore dhe Arkeologjike
- Impakti ndaj Mjedisëve të Punës dhe Shendetit Human
- Ndikim social
- Menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara

Impakti mbi Tokë

➤ Impakt i përherëshëm :Tjëtërsim në përdorimin e tokës

Ndryshimet në kende të pjerreta gjatë ndërtimit të trungut të rruges apo karakteristika të tjera përgjatë rruges (p.sh. hapja e gropave apo urat) mund të çojë në ndryshime të tokës / stabilitetit të saj dhe mund të shkaktojë erozion. Ndikimet e tilla do të jenë të rëndësishme në një shkallë lokale. Ndikimet e tilla potenciale mund të shmangen në fazën e projektimit, ose të kufizohen përmes përdorimit të masave lehtësuese. Prandaj, ndikimi i mbetur është konsideruar të jetë e rëndësishme (negativ).Ndikimi do të jetë i përherëshëm dhe i pakthyeshem.

- Impakti gjate fazes se ndertimit të unazës së re:

Potencial për ndotje të sipërfaqes së tokës për shkak të rrjedhjeve, pikimeve aksidentale të hidrokarbureve, lubrifikanteve nga pajisje, nga makinerit të cilat operojnë në sheshin gjatë fazës ndërtimore.

Potencial ne erozionine tokës gjatë punimeve për ndërtimine argjinaturës prane lumit dhe kanaleve kulluese.

- Gjatë fazes operacionale, vënies në funksionim

Nuk pritet të ketë ndikim në cilësinë e tokës pas përfundimit të proceseve ndërtimore.

Impakt në burimet ujore

- Impakti gjate fazes se ndertimit

Per te mos reduktuar burimet qe sherbejne per furnizimin e ujerave nentokesore apo qe mund te sjellin problem ne furnizimin me uje te komuniteteve lokale duhet te merren ne konsiderate faktore si: stina e pranveres (ku keto ujera kane potencialin me te larte prures), ose periudha e veres kur keto burime kane prurje te ulet; faktore te cilet te konsiderohen ne kohezgjatjen e punimeve.

Impakti në Cilësinë e Ajrit

- Impakti gjatë fazës ndërtimore

Ajri i paster eshte thelbesor per shendetin e njerezve dhe ekosistemeve mjedisore. Nje shumellojshmeri e ndotesve te ajrit jane te njohura ose dyshohet te jete e demshme per shendetin e njeriut dhe mjedisin. Ne shumicen e vendeve te Evropes, keta ndotes jane kryesisht produktet e djegies nga ngrohja, prodhimi i energjise dhe nga trafiku i automjeteve motorike. Emetimet kryesore qe mund te ndikojne ne shendetin e njeriut dhe burimet ekologjike gjate ndertimit te rruges jane te NO2 dhe PM10. Perveç ketyre ndotesve, pluhuri i ndertimit eshte nje faktor kyç sepse zona e studimit ne kushtet e ndertimit do te gjeneroje pluhur gje e cila mund te shkaktoje problematika per komunitetin apo faktore te tjere. Aktivitetet e ndertimit ne pergjithesi japin rritje te koncentrikeve afatshkurtra te pluhurit te ngritur. Faktor ndikues ne kete rritje jane levizjet e automjeteve, (ndotja qe vjen nga levizjet e automjeteve ne rruget nen ndertim) si edhe nga materialet stok te ndertimit te ekspozuara ndaj eres

Impakti mbi biodiversitetin

- Impakti gjatë fazës ndërtimore:

Ndikimi ne fazen e ndertimit perfshin humbjen e perhershme te habitatit ne pjesen ku do te shtrihet gjurma e rruges si edhe ndikimin indirekt per pjesen prane gjurmes se rruges si pasoje e pluhurave dhe tymrave te automjeteve. Ndikimet e mundshme do te jene humbja e habitateve te foleve per zogj migratore apo per gjitare te vegjel. Ndikimet e perkohshme per tokat me bimesi dhe afat-shkurter mbi kafshe te veçanta per aq kohe sa do te duhet per pastrimin e vegjetacionit dhe per dhe perfundimin e punimeve te ndertimit. Pluhuri i lidhur me aktivitetet e ndertimit do te kete efekt afatshkurter, dhe ndikim te perkohshem ne bimesi, qe zgjat vetem per aq kohe sa periudha e nevojshme per pastrimin dhe asfaltimin e rruges. Bimesia apo vegjetacioni te cilat do te priten si rrjedhoje e ndertimit te rruges mund te kerkohen te kompensohen per tú mbjelle ne vende te tjera te zones ku mund te jete e nevojshme. Ne kete aspekt duhet te koordinohet me pushtetin lokal qe administron kete zone. Ndikimi ne fazen e ndertimit perfshin edhe ndikimin indirekt per pjesen prane gjurmes se rruges si pasoje e pluhurave dhe tymrave te automjeteve. Ndikimet e mundshme do te jene humbja e habitateve te foleve per zogj migratore apo per gjitare te vegjel.

Impakti Vizual dhe Peizazhi

- Impakti nga faza ndertimore:

Si cdo proces pune në fushën e ndërtimit, edhe gjatë fazës ndërtimore të këtij projekti pritet të kemi ndryshime të përkohshme por edhe të përhershme në mjedis, pra ndikim në peisazh. Disa ndikime të përgjithshme janë;

- Ndryshime në pamjen vizuale përgjatë gjurmës së projektit ku do kryhen punimet.
- Ndryshime të pamjes nga instalimi i pajisjeve dhe makinerive të ndërtimit që do të përdoren dhe do të intalohen perkohesitsh gjatë fazës ndërtimore.

Gjate fazes se ndertimit ,perkohesisht do të ndikohet negativisht peisazhi (psh, prania e grumbujve me dhe, inerte apo materiale te ndertimit). Ky ndikim do te jete i perkohshem

Impakti nga Zhurmat

- Faza ndertimore

Lidhur me emetimin e zhurmave gjatë fazës ndërtimore, duhet theksuar se ky ndikim është i përkohshëm.

Burimet e zhurmës mund të jenë të shumta dhe mund të shkatohen nga punimet ndërtimore nga pajisjet gjeneratorët, makinerit si eskavatorët, kamionët transportues etj .Impakti i zhurmës do ndihet në zonën e kantierit dhe në afersi me objektet pranë tyre .

- Gjate fazës se operimit :

Gjate proceseve te punes makinerite dhe pajisjet emetojne zhurma te cilat mund te jene shqetesuese si per qeniet humane ashtu dhe per faunen prane zones ku do te zbatohet projekti. Kjo sepse ne faza te ndryshme te projektit makinerite qe do te perdoren shkaktojne zhurma ne mjedis. Tabela e meposhtme paraqet zhurmat standarde te makinerive te ndertimit nje pjese e te cilave do te perdoret dhe gjate ndertimit te kesaj rruge. Ne disa raste do te jete e nevojshme dhe perdorimi i gjeneratoreve kur energjia elektrike nuk do te kete aksesin e duhur apo ne mungese totale te saj.

Impakti në Trafikun Rrugor

- ***Faza ndertimore***

Gjate fazes ndertimore pritet te kete impakt ne trafik, i cili do duhet te menaxhohet nepermjet nje plani te menaxhimit te trafikut te hartuar nga kompania zhvilluese dhe te miratuar nga organet kompetente.

Aktualisht ne kete rruge per shkak te gjendjes se saj trafiku eshte shume i ulet, por me ndertimin e saj per faktin se ajo do te shkurtoje distancat, do aksesojte mundesine per rritjen e turizmit, sherbimeve, tregtise mund te parashikohet nje rritje prej 100 % e trafikut aktual; llogaritet nje numer prej 300-600 automjete/ 24 ore ne kete logjike do te parashikojme dhe ndotjen qe mund te vije si rrjedhoje e trafikut. Situata per ndotjen nga PM10 dhe PM2.5. Pluhurat jane nje nga ndotesit e ajrit qe realisht shkaktojne probleme serioze ne shendetin e njeriut. Ndotja nga PM10 dhe PM2.5 sipas rekomandimeve te OBSH eshte rreziku me i madh shendetesor sot per ajrin urban ne shkalle boterore, pasi grimcat me permasa nen 10 mikron dhe 2.5 mikron mund te depertojne ne pjesen e poshtme te mushkerive. Kjo ndotje vjen

kryesisht nga shkarkimet e automjeteve dhe është karakteristike për makinat e vjetra me motor dizel. Gjithashtu ndertimi dhe infrastruktura në ndertim janë kontribuues në rritjen e PM10. Legjislacioni shqiptar aktualisht nuk ka standarde të pranuar apo kufij të vendosur për normat e depozitimit pluhurit. Megjithatë, normat ditore mesatare të depozitimit të pluhurit mund të përdoret për të treguar ndonjë ndikim të mundshëm problematik. Kodi rrugor i Britanise lejon një normë maksimale prej 200 miligram (mg) në ditë për meter katror pas të cilit depozitimi i pluhurit mund të jetë problematik (mund të shkaktojë aksidente). Kjo normë jepet sipas tabelës së mëposhtme.

Impakti në Trashëgiminë Kulturore dhe Arkeologjike

Është konsideruar se arkeologjia e Shqipërisë mbetet akoma me vende të panjohura dhe të pazbuluara dhe është e mundur që vlera arkeologjike mund të hasen kudo përgjatë korridorit të ndertimit në zonat ku nuk ka studime të mëparshme arkeologjike. Si e tillë, do të jetë e nevojshme për të lejuar arkeologe të kualifikuara për të monitoruar procesin e heqjen e shtresës së dheut gjatë procesit të ndertimit të rrugës, nderhyrjeve në peizazh, ose krijimin e zonave të mbetjeve, gjatë hapjes së gropave etj. Kjo do të kërkojë bashkëpunim të ngushtë midis kontraktorit dhe ekipit arkeologjik të mundësuar që të gjitha punimet të ecin mirë dhe të kontrollohen për karakteristika arkeologjike para fillimit të punimeve në thellesi të metejshme që do të shkatërronin karakteristika të tilla. Çdo mbetje arkeologjike që mund të haset gjatë gërmimit duhet të regjistrohet në një nivel proporcional me rëndësinë e saj, në një mënyrë të tillë në mënyrë për të minimizuar vonesat në afatet e ndertimit.

Impakti ndaj Mjedisve të Punës dhe Shëndetit Human

Impakti nga ndertimi:

Për parandalimin e ndikimeve negative në shëndet dhe mjedis të veprimtarive ndertimore, të cilat mund të lindin gjatë fazës së ndertimit nga mos zbatimi i rregullave të sigurisë në punë, nga mos marrja e masave paraprakë të sigurisë, kompania zbatuese në terren duhet të implementojë një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në mjediset e punës (HSE), që përcaktohen për veprimtaritë ndertimore sipas legjislacionit përkatës.

Faza pas ndertimit

Nuk pritet të ketë ndikim negativ pas përfundimit të proceseve ndertimore

Ndikimet Sociale

Ndikimet Pozitive Sociale

Zhvillimi i këtij projekt shoqërohet me efekte pozitive sociale si vijon:

Ky aks do të ndikojë në ofrimin me të mirë të shërbimeve baze (arsimimit, shëndetësisë, shërbimeve publike) si rrjedhojë e lidhjes së re që do të krijohet zonat nëpër të cilat kalon ky aks rrugor. Komuniteti do të shkurtohet koha për të udhëtuar për arsye të ndryshme apo për të marrë një shërbim të duhur pranë pushtetit vendor, shërbimit publik dhe me gjere. Po kështu zonat mund të krijohet marrja e shërbimeve të tjera që lidhen indirekt me praninë e një aske rrugor të parametrave bashkohore si: Sistemi i ri i furnizimit me ujë të pijshëm, sistemi i ri kanalizimesh të ujërave të bardha dhe të zeza, telefonia fikse, internet, etj

Gjenerim mbetjesh

Gjatë fazës ndërtimore do të gjenerohen mbetje inerte ndërtimi por edhe mbetje urbane nga aktiviteti human i punonjësve që operojnë për ndërtimin e objektit.

5.2 Shkarkimet në mjedis ngandërtimi dhe zhvillimi i projektit

Gjatë fazës ndërtimore, fazë e cila është relativisht e limituar deri në 1 vit, për rrjedhojë edhe shkarkimet

5.2.1 Shkarkimet e ujërave të ndotura, gaze , pluhur, zhurma, vibrime dhe mbetjet e gjeneruara

në mjedis janë të karakterit të përkohshëm dhe relativisht aftashkurtër, janë vlerësuar shkarkimet e pritshme në mjedis si vijon :

- Dhera nga germimet
- Mbetje inerte gjatë fzaës ndërtimore (mbetje nga ndërtimi)
- Mbetje urbane nga aktiviteti human i kompanisë që operon në kantier
- Emetime PM10 ;PM2.5 TSPM ;
- Emetime zhurma
- Emetime gaze nga djegia e karburantit të automjeteve që punojnë në kantier si dhe gjate asfaltimit të rrugës .
- Gjenerim ujra të zeza nga aktiviteti human i punonjësve që operojnë në kantier

5.2.2 Shkarkimet urbane ujëra të zeza , mbetje urbane nga aktiviteti human i punonjësve të përfshirë ne projekt

Për ndërtimin e këtij objekti do angazhohen punonjës përfshirë edhe stafin inxhinierik .Numri i punonjësve do të varioje nga specifikat e ndërtimit dhe kohës së kërkuar për realizimin e një procesi ndërtimor.

Në këto kushte do kemi edhe shkarkime në mjedis nga aktiviteti human i këtyre punonjësve të përfshirë në projekt.

Mbetjet urbane te gjeneruara nga aktiviteti human i punonjësve që operojnë në projekt do të grumbullohen dhe menaxhohen nga kompanitë që menaxhojnë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane në qytetin e Gjirokastrës ,sipas mërrëveshjeve përkatëse kontraktuale.

Ujrat e zeza do të menaxhohen nëpërmjet nënkontraktoreve të licensuar për grumbullim dhe trajtim ujra të zeza (mini tualete protative ose nga gropa septike) për raste kur do linde nevoja të perdoren tualete protative dhe nuk do kete mundësi te perdoret infrastruktura egzistuese e kanalizimeve te ujrave te zeza dhe te bardha te qytetit te Gjirokastrës.

Sasia e mbetjeve te gjeneruara nga aktiviteti human konsiderohet jo sinjifikativ referuar mbetjeve urbane të gjeneruara nga banoret e qytetit te Gjirokastrës

Meqense punonjesit e perfshire ne projekt do jene banore te zones (GJIROKASTER),mbetjet urbane nga aktivitetit human jane pjese e po të njejtës matrice , lokalitet , vendshkarkim dhe depozitimi i mbetjeve sikurse ata të ishin duke ushtruar një aktivitet tjetër brenda rajonit Gjirokastrës.

5.3 Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar

Për të përcaktuar më mirë masat për kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve negative të identifikuar gjatë procesit të VNM, në këtë paragraf është bërë një kategorizim i rëndësisë së çdo ndikimi të mundshëm negativ në mjedis të projektit. Ky kategorizim është kryer bazuar në vlerat mjedisore të zonës, legjisllacionin mjedisor në fuqi dhe njohuritë mbi teknologjinë dhe teknikën e kryerjes së operacioneve ndërtimore.

5.3.1 Vlerësimi i Rëndësisë së Ndikimeve Negative Mjedisore

Natyra e ndikimeve mund të kategorizohen në terma të:

- Drejtimit (kahjes)- Pozitive apo negative
- Kohëzgjatjes - Afatgjatë apo afat shkurtër
- Vendndodhjes - Direkt ose indirekt
- Magnitudës - E madhe apo e vogël
- Shtrirjes - E gjerë apo lokale
- Rëndësisë - E madhe apo e vogël

Tabela.-8:Metodika e vlerësimit të rëndësisë së ndikimeve të mundshme negative në mjedis

Kategoria	Përshkrimi
I ulët	Ndikimi është i përkohshëm,dëmton pak vlera natyrore si në cilësi dhe në sasi (volume). Me përfundimin e operacionit që e shkakton ai nuk jep më efekte në mjedis.
I mesëm	Ndikimi është i përkohshëm por në mungesë të masave kontrolluese dhe menaxhuese mund të shkaktojë ndikime afatgjata në vlerat natyrore. Sipërfaqja që tjetërsohet nuk rikthehet më në gjendjen e saj por zë një raport të pranueshëm me sipërfaqen totale të zonës (koeficienti i tjetërsimit) si dhe tjetërsohet vetëm sipërfaqja ndërtimore e objektit. Ndikimi nuk përfaqëson shkarkime të ndotësve në mjedis
I konsiderueshëm	Ndikimi është i përhershëm dhe del përtej zonës së ndikuar (zhvendosje, ndotje, zhurma e shkarkime në ajër). Ndikimi kompromenton normat e shkarkimeve në mjedis dhe normat e përdorimit të mjedisit

I kthyeshëm	Mbaron efektin me ndalimin e shkakut dhe mjedisi i ndikuar rifiton gjendjen e tij natyrale. Dëmton vlera/zona të mbrojtura dhe unikale
Pjeserisht kthyeshem	Efekti vazhdon pjeserisht edhe pas nderprerjes se shkakut qe e shkakton ate.(vazhdon efektin negative ne mjedis pjeserisht)
I pakthyeshëm	Pasojat e ndikimit janë të pakthyeshme (vazhdojnë efektin negativ në mjedis) edhe pasi përfundon veprimi që shkakton ndikimin

Për të identifikuar sistematikisht ndikimet që lidhen me ndërtimin e objektit të propozuar,është ndërtuar një matricë e ndikimit e cila vendos përballë aktivitetet kryesore të projektit kundër faktorëve relevantë mjedisorë. Kjo matricë është paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela- 9:Matrica e Ndikimeve në Mjedis në Fazën e Ndërtimit dhe ne mbyllje te punimeve ndërtimore

	Aktiviteti/ Impakti	Drejtimi (kahja)		Kohëzgjatja			Burimi i impaktit		Magnituda			Shtrirja		Rëndësia		
		Pozitiv	Negativ	Afatgjatë	Afatmesëm	Afatshkurtër	Direkt	Indirekt	Madhe	Mesme	Vogel	E Gjerë	Lokale	Madhe	mesme	Vogel
A	Gjate kryerjes se punimeve ndertimore															
	Zhurma, vibrime		X			X	X			X			X			X
	Pluhuri		X			X	X			X			X			X
	Tjetërsim në përdorimin e tokës		X	X			X				X		X		X	
	Emetime te gazeve të makinerive që operojnë në objekt		X			X	X				X		X			X
	Pamja vizuale		X			X	X				X		X			X
	Gjenerimi i dherave nga gërmimet		X			X	X			X			X		X	
	Gjenerimi i mbetjeve urbane nga aktiviteti human i kompanisë		X			X	X				X		X			X
	Gjenerim i mbetjeve inerte nga ndertimi(mbetje ndertimore)		X			X	X				X		X			X
	Gjenerimi i ujërave të zeza nga aktiviteti human i kompanisë		X			X	X				X		X			X
	Ndotje e tokës si pasojë e avarive të mekanike në zonën e projektit		X			X	X				X		X			X
	Erozion i tokes për shkak te punimeve prane brigjeve te lumit dhe kanaleve		X			X	X				X		X			X
	Impakt në vegjetacion egzistues gjatë fazës së ndërtimit		X		X		X				X		X			X
	Krijimi i vendeve të punës	X				X	X			X			X		X	

B	Transporti i materialeve për në objekt															
	Emetime Pluhuri gjate ngarkimit, transportit të materialeve.		X			X	X				X		X			X

	Aktiviteti/ Impakti	Drejtimi (kahja)		Kohëzgjatja			Burimi i impaktit		Magnituda			Shtrirja		Rëndësia		
		Pozitiv	Negativ	Afatgjatë	Afatmesëm	Afatshkurtër	Direkt	Indirekt	Madhe	Mesme	Vogel	E Gjerë	Lokale	Madhe	mesme	Vogel
	Emetime të gazeve të makinave të transportit të materialeve dhe proceseve të asfaltimit		X			X	X				X		X			X
	Rendim i trafikut nga qarkullimi i automjeteve		X			X	X			X			X			X
C	Në perfundim të procesit ndërtimor															
	Zhvillimi i zonës urbane .Permisimi i infrastruktures se zones	X		X			X			X		X		X		
	Pamja vizuale e zonës pas ndërtimit të objektit	X		X			X				X		X	X		
	Përmisimi i trafikut	X		X			X			X			X	X		
	Impakt ne zhvillimin e turizmit	X		X			X			X			X	X		

5.4 Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të

Per shkak te karakterit te projektit, gjatësisë relativisht te kufizuar te gjurmës së projektit prej 980 m , referuar proceseve te punës , makinerive dhe pajisjeve qe do perdoren dhe kohezgjatjen e procesit ndertimore,duke zbatuar masat parandaluese , reduktuese dhe rehabilituese te ndikimeve potenciale negative te vlerësuara te sugjeruara per tu zbatuar sipas kësaj VNM , nuk pritet qe impaktet e vlerësuar negative te kenë shtrirje hapësinore përtej zonës se projektit.

Ato jane parashikuar te minimizohen dhe lokalizohen ne sheshin e ndërtimit dhe jane vlerësuar jo signifkante ne zonën përreth gjurmës se projektit .

Tabela e mësipërme (“Matrica e Ndikimeve në Mjedis në Fazën e Ndërtimit) jep një përmbledhje kryesore te ndikimeve si dhe të shtrirjes së ndikimeve në hapësirë dhe kohë.

5.5 Mundësitë mbi rehabilitimin e mjedisit të ndikuar nga projekti

Në mbyllje te procesit të ndërtimit të projekti do të behet cmobilizimi i pajisjeve , makinerive nga kantjeri , zona e punes .

Sheshi si dhe cdo segment i rrugës së ndërtuar do te pastrohet nga cdo mbetje e mundshme e krijuar nga cmontimi i makinerive dhe pajisjeve, apo nga procesi ndertimor .

Te gjitha sheshet e perkohshme të perdorura për qëllime të ndërtimit të këtij projekti (kantjer , parkimi i automjeteve , makinerive) do të rikthehet ne gjendjen e mëparshme (ashtusikrse ishin para se te fillohej procesi ndërtimor).

Të gjitha materialet e ndërtimit , mbetje ne fund te procesit te ndërtimit (si hekura , asfalte , inerte) do te largohen nga kantjeri per tu riperdorur (ricikluar)më pas.

5.5.1 Mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme

Referuar karakteristikave egzistuese mjedisore te zonës së projektit ,projektit teknik , vendodhjes , shtrirjes hapësinore si dhe kohëzgjatjes se kufizuar të procesit te ndertimit, masat paraprake te parandalimit te ndotjes të rekomanduara në këtë raport të vleresimit të ndikimit në mjedis , janë të gjitha mundësite që kompania ndërtuese te rehabilitojë në nje kohe relativisht te shkruter (brenda 1 jave) te gjitha sheshet e ndikuara nga ndërtimi i këtij projekti (përfshire sheshet e perkohshme apo përgjatë gjurmës së projektit).

Gjithësesi , rekomandohet me përparësi që kompania ndërtuese të përzgjedhe sheshe për qëllime të përdorimit të perkohshme (si për kantjer,parkimi i automjeteve) të cilat kërkojnë rehabilitime minimale dhe impakte mjedisore minimale.

5.6 Masat e Mundshme për Shmangien dhe Zbutjen e Ndikimeve Negative në Mjedis

5.6.1 Impakti mbi Tokë

Masa parandaluese të rekomanduara për tu zbatuar:

Sasia e dherave të gjeneruara nga proceset e germimit fillimisht do depozitohet, ruhet në afërsi me zonën e germimit. Gjithashtu për të ruajtur këto depozitime nga erozioni apo shkarrjet nga rreshjet e shirave, ajo do të rrethohet me një barrier gjeotekstili apo silt fence.

Për të parandaluar kontaminimin e tokës nga ndonjë derdhje, pikim i hidrokarbureve nga makinerit, automjetet gjate manovrimeve, enët që mbajnë kimikate, hidrokarbure, vajra etj do të pajisen me një kontenier ekstra, e cila vendoset në kontakt me tokën për të shmangur kontaktin e drejtperdrejt të enëve, bidonave me vajra, hidrokarbure apo kimikate të ndryshme me tokën.

Një komplet (spill kit) me të gjitha mjetet e nevojshme për të pastruar çdo pikim, rrjedhje aksidentale të mundshme të këtyre kimikateve, do gjendet në gadishmëri në kantier për të vepruar në raste të ndodhjes së një incidenti kontaminimi.



Figure-10: Masa mbrojtëse ndaj kontaminimit

Në vijim po japim përmbledhje të ndikimeve të pritura dhe masave zbutëse të sugjeruara për tu zbatuar gjate zhvillimit të projektit.

5.7 Impakt në burimet ujore

Gjate fazes se ndertimit:

Masa parandaluese të rekomanduara për tu zbatuar:

Depozitimi i mbetjeve të ngurta inerte dhe dherave të gjeneruara gjatë fazës së germimit sipas praktikave më të mira të disponueshme. Vendosja e silt fence(barrierave) që pengojnë marrjen e masave të dherave nga uji i shiut. Largimi i materialit inert të panevojshëm nga sheshi i ndërtimit për në vendin final të depozitimit apo riperdorimit (nese). Hapja e kanaleve provizor të kullimit brenda kaniterit, kur shihet e nevojshme (sipas rastit specifik).



Figure.-11 Përdorimi i silt fence pranë burimeve ujore

Gjate fazes operationale :Nuk pritet të ketë ndikim negativ gjate fazes operationale si dhe pas përfundimit të procesit ndërtimor

5.7.1 Impakti në Cilësinë e Ajrit

Gjatë fazës ndertimore

Masa parandaluese: Projekti i ndërtimit duhet të zbatojë të gjitha masat për të reduktuar sa më shumë ndikimet negative në mjedis. Punimet e gjermimit do të kryhen duke bere lagie me ujë të sipërfaqes për të ulur emetimin e grimcave të pluhurit, si dhe vecimin apo menjanimin e të gjitha mbetjeve të ngurta të rezultuara gjatë proceve të germimit.

Përdorimi me eficence i makinerive që konsumojnë karburant për të ulur konsumin e panevojshëm të lëndës djegëse dhe për rrjedhojë duke ulur dhe sasinë e emetimeve të CO₂, SO₂, NO_x, VOC që emetohen nga djegia e karburantëve. Ndotja potenciale e ajrit si pasojë e operationeve të ndërtimit vlerësohet të mos i tejkalojë normat e cilësisë së ajrit për qëndrat e banuara që përcaktohen në VKM nr.803 datë 04.12.2003 “Për normat e cilësisë së ajrit”.

Lagia e rrugëve dhe e zonave të prekura nga ndertimi, spërkatja me ujë do të përdoret për minimizimin e pluhurit. Spërkatja do të kryhet atëherë kur është e nevojshme, për shëmbull kur janë kushtet e motit të thatë dhe/ose erëra të forta.

Ujërat e përdorur për këtë qëllim duhet të përdoren në sasi të cilat nuk do të rezultojnë në krijimin e rrjedhave. Kufizimi në minimum i disa aktiviteteve sic janë gjermimi dhe levizja e makinave gjatë

erërave të forta.

Reduktimi i shpejtësisë së lëvizjes në një nivel ku ngirjta e pluhurave është minimale. Ujitja (me zorrë) e agregatit dhe grumbulli të materialeve gjatë erërave të forta.

Grumbulli i dherave duhet të pozicionohet në një mënyrë që nuk është e cënueshme ndaj erozionit të erës. Burimi i ujit :I gjithë uji për qëllimin e kontrollit të pluhurit do të nxirret nga burime të vlerësuar dhe aprovuar. Kontraktori do të regjistrojë sasine e ujit të përdorur.

Transportuesit e materialeve të lehta duhet të sigurojnë që operacionet e tyre nuk paraqesin problem nëpërmjet derdhjes së materialit ose krijimit të pluhurave. Ëshë e rekomandueshme që ngarkesa e të gjitha makinave të transportit të jenë të mbuluara me mushama kundra ujit.

Të gjithë kamionat ose makineritë që largojnë dherat nga sheshi duhet të kenë kazanët ngarkues të mbuluar me mushama për të parandaluar gurët dhe dherat të bien në sipërfaqet e rrugëve ose të shkaktojnë shqetësime për personat në afërsi.

Automjetet nuk lejohen të dalin në rrugët e asfalta me goma me balte .Ato duhet të pastrohen brenda sheshit të kantierit para daljes së tyre në rrugët e asfalta të qytetit .Makinat do të lahen dhe pastrohen brenda kantierit para se të dalin në rrugët e qytetit .

Tabela.-10:Normat e cilësisë së ajrit për qendrat e banuara

Standarti	PM10 ($\mu\text{g}/\text{m}^3$)	TSPM ($\mu\text{g}/\text{m}^3$)	SO2 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	VO C $\mu\text{g}/\text{m}^3$	NO2 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	CO $\mu\text{g}/\text{m}^3$	O3 $\mu\text{g}/\text{m}^3$
Directive 2008/50/EC of the European Parliament and of the Council of 21 May 2008 on ambient air quality and cleaner air for Europe	60	100	40	5	40	1000	120
VKM Nr.803, date 4.12.2003 “Per normat e cilësisë së ajrit në mjedis”	60	140	60	5	60	2000	65

5.7.2 Impakti mbi biodiversitetin

Per te vleresuar rendesine dhe permasat e ndikimeve te ndryshme qe mund te rezultojne nga zbatimi I projektit, keta faktore jane krahasuar me faktoret e nje zone tip. Vlera e cdo tipari ekologjik qe do te preket I perket nje shkalle gjeografike te nje rendesie te caktuar ekologjike, dhe kjo eshte kjo klasa e vleres ekologjike e cila eshte vleresuar ne aspektin e rendesise apo permases se ndikimit. Ndikimet e mundshme do te jene humbja e habitateve te foleve per zogj migratore apo per gjitare te vegjel. Ndikimet e perkohshme per tokat me bimesi dhe afat-shkurter mbi kafshe te vecanta per aq kohe sa do te duhet per pastrimin e vegjetacionit dhe per dhe perfundimin e punimeve te ndertimit. Pluhuri I lidhur me aktivitetet e ndertimit do te kete efekt afatshkurter, dhe ndikim te perkohshem ne bimesi, qe zgjat vetem per aq kohe sa periudha e nevojshme per pastrimin dhe asfaltimin e rruges. Bimesia apo vegjetacioni te cilat do te priten si rrjedhoje e ndertimit te rruges mund te kerkohen te kompensohen per tu mbjelle ne vende te tjera te zones ku mund te jete e nevojshme. Ne kete aspekt duhet te koordinohet me pushtetin lokal qe administron kete zone. Ndikimi ne fazen e ndertimit perfshin edhe ndikimin indirekt per pjesen prane gjurmes se rruges si pasoje e pluhurave dhe tymrave te automjeteve. Ndikimet e mundshme do te jene humbja e habitateve te foleve per zogj migratore apo per gjitare te vegjel.

5.7.3 Impakti Vizual dhe Peizazhi

Masat parandaluese :

Zona e ndertimit do te rrethohet duke shmangur keshtu pamjen nga kalimtarët dhe reduktuar ne një farë mase edhe impaktin negative.

Sistemimi i materialeve brënda kantierit të punës dhe largimi i mbetjeve inerte të gjeneruara për në destinacionin përfundimtar janë masa të tjera zbutëse për reduktimin e impaktit visual.

Faza pas përfundimit të ndertimit.

Pamja vizuale e zonës pas ndertimit te këtij objekti do te permisohet ndjeshëm sipas standarteve bashkohore .

5.7.4 Impakti nga Zhurmat

Masat parandaluese

- Përdorimi i veshjeve mbrojtëse për pajisje (si gjeneratore etj) që janë burime të konsiderueshmetë zhurmave, për të reduktuar nivelin e emetimit të tyre. Izolim akustik i objektit mund të bëjnë dhe nivelin e arritur të zhurmës shumë të ulëta dhe prania e pa kuptueshme e makinerisë që emeton zhurmën.
- Përdorimi i makinerive dhe pajisjeve që emetojnë zhurma brënda standarteve të lejuara sipas katalogut të deklaruar të prodhuesit
- Përdorimi i barrierave mbrojtëse që reduktojnë ndjeshëm nivelin e zhurmave sidomos në afërsi me godinat, institucionet për të cilat emetimi i zhurmave do shkaktonte shqetësim, bezdi. Cdo rritje e lartësisë se barrierave mbrojtëse me 1 m lartësi, redukton nivelin e zhurmave me 1.5 dB.

- Vendorsja e pajisjeve, makinerive që emetojnë zhurma në drejtimin e duhur e cila do lehtësonte, reduktonte përhapjen e zhurmave ndaj një drejtimi objektivi tjetër më të ndjeshëm ndaj zhurmave.
- Bazuar edhe në referencat ndërkombëtare vlerësohet se zhurmat teknologjike nga mjetet e rënda e japin efektin e tyre kumulativ deri në një rreze prej 150 - 200m në varësi edhe të konfiguracionit natyror të terrenit i cili luan rolin e një barriere natyrale etj. Për rrjedhojë pritet që të ndikohen negativisht nga zhurmat e pajisjeve të rënda si eskavatorë, kamionë etj, objektet shumë afër zonës së projektit (150-200 m).
- Përdorimi i teknikave dhe i pajisjeve konform standarteve të BE që emetojnë nivele zhurme brenda nivelit të lejuar (sipas patentës së prodhuesit) do të minimizoj ndikimin e tyre në mjedis
- Mirembajtje e pajisjeve dhe makinerive që janë burime emetimit
- Monitorimi i niveleve të zhurmave
- Aplikimi i brezave mbrojtës në raste kur vihet re nivele të larta zhurme

Në vijim po japim pamje të përdorimit të barrierave mbrojtëse ndaj zhurmave në një kantiër ndërtimi:




Figure -12:barriera të përkohshme mbrojtëse ndaj zhurmave të sygjera për reduktimin e nivelit të zhurmave

Niveli i Lejuar i Zhurmave²

Sipas Stabdarteve të legjislacionit të Shqipërisë, niveli i lejuar i zhurmave është si vijon:

Zonë industriale

² MINISTERIA E MJEDISIT, PYJEVE MINISTERIA E SHENDETËSISË DHE ADMINISTRIMIT TË UJERAVE UDHEZIM (Nr.8, date 27.11.2007) “PER NIVELET KUFITË ZHURMAVE NE MJEDISE TE CAKTUARA

Orët e ditës (07:00 – 22:00) 70 dBA

Orët e natës (22:00 – 07:00) 70 dBA

Zonat e banuara dhe insitucionet arsimore edukative

Orët e ditës (07:00 – 22:00) 55 dBA

Orët e natës (22:00 – 07:00) 45 dBA

Gjate fazes operationale, (vënies në shfrytëzim të godinës) Nuk pritet ndikim lidhur me zhurmat

5.7.5 Impakti në Trafikun Rrugor

Masa parandaluese:

- Plan menaxhimi i trafikut .
- Përdorim i sinjalistikës rrugore përgjatë akseve ku punohet për të njoftuar përdoruesit e rrugës si dhe publikun mbi punimet që kryhen.
- Shmangie kur është e mundur nga ndërtuesit e levizjeve të automjeteve të transportit gjatë orëve pik të trafikut. Zgjedhja e orëve më pak të ngarkura prej tyre.

5.7.6 Impakti në Trashëgiminë Kulturore dhe Arkeologjike

Masa parandaluese: Kryerja e veprimeve ndërtimore duhet të bëhet në përputhje me të gjitha kërkesat

ligjore dhe miratimeve respective mbështur në ligjin nr. 9048 me date 07.04.2003 “Per trashëgiminë kulturore” ndryshuar me ligjin Nr 9885 date 28.02.2008 “Për trashëgiminë kulturore” (I azhornuar).

Kur, pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjike-etnologjike, (gjate punimeve nën tokë për hapjen e kanaleve) punimet ndërpriten menjëherë. Supervizori i punimeve njoftojnë, brenda tri ditëve, organet e qeverisjes vendore, Institutin e Arkeologjisë dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës, të cilët bëjnë kontrollin përkatës, raportojnë për vlerat e gjetura dhe bëjnë propozimet përkatëse për vazhdimësinë ose jo të punimeve.

Nëse gjetjet janë me vlera të rëndësishme, punimet e filluara mund të pësojnë ndryshime ose të ndërpriten përfundimisht. Vendimi në këtë rast merret nga organi që ka autorizuar fillimin e punimeve

Nuk pritet të ketë ndikim pas përfundimit të proceseve ndërtimore .

5.7.7 Impakti ndaj Mjedisëve të Punës dhe Shëndetit Human

Impakti nga ndertimi:

Per parandalimin e ndikimeve negative ne shendet e ne mjedis te veprimtarive ndertimore, te cilat mund te lindin gjate fazes se ndertimit nga mos zbatimi i rregullave të sigurisë në punë, nga mos marrja e masave paraprakë të sigurisë, kompania zbatuese në terren duhet të implementojë një system menaxhimi të shëndetit dhe sigurise në mjediset e punës (HSE), që përcaktohen për veprimtarite ndërtimore sipas legjislacionit përkates.

Faza pas ndërtimit

Nuk pritet të ketë ndikim negativ pas përfundimit të proceseve ndërtimore

5.7.8 Ndikimet Sociale

Ndikimet Pozitive Sociale

Gjatë fazës ndërtimore do kemi këto ndikime sociale qe lidhen drejtpërdrejt me ndërtimin e këtij projekti.

- Përmisimi i infrastruktures dhe rrjetit rrugor per komunitetin e qytetit te Gjirokaster dhe perdoruesit e rruges ,
- Përmisim i industrise turistike si pasoje e përmisimit te infrastrukturës rrugore prane zonës së UNESCO-s
- Reduktim i nivelit te zhurmave dhe përmisim i cilësisë se ajrit , cilësisë së jetës per banoret aty prane.
- Punësimi i përkohshem për komunitetin i cili do të të marrë pjesë drejtpërdrejt në proceset e ndërtimit , gjë e cila do të sjellë një kontribut të dobishëm në të ardhurat familjare (hapja e vendeve të punës);
- Rritje të ardhurash për shërbimet shtesë që do të duhet të behen për punonjësit që do te merren me ndërtimin e këtij projekti.
- Rritje e standartit te shërbimeve per komunitetin.
- Përmisimi urban i zonës së projektit sipas planeve zhvillimore te Gjirokastrës.

5.7.9 Ndikimi ne reduktimin i ndotjes dhe uljen e shpenzimeve te transportit:

Ky aks rrugor pritet te cliroje trafikun ne qytet sepse eshte nje rruge alternative per te shkuar nga Mashkullora drejt Dervicianit pa kaluar permes qendres se Gjirokastrës. Clirimi i trafikut redukton emetimin ne atmosfere te gazrave ndotes te shkaktuara nga qarkullim i automjeteve si edhe ul ndotjen akustike prane qendrave te banuara. Po keshtu nje rruge e parametrave bashkohore eshte nje faktor pozitiv ne uljen e sasise se karburantit per njesi te gjatesise se rruges, ne shërbimet periodike te automjeteve(nderrim gomash, vaji, pjesesh te tjera kembimi) si edhe krijon nje mundesi shume te mire te rritjes se sigurise te qarkullimit te mjeteve (sinjalistike e re, mbrojtese anesore etj.)

5.7.10 : Masat e rekomanduara per mbrojtjen e mjedisit

Arkeologjia

Vezhgimi gjate fazes se ndertimit

Eshte konsideruar se arkeologjia e Shqiperise mbetet akoma me vende te panjohura dhe te pa zbuluara dhe eshte e mundur qe vlera arkeologjike mund te hasen kudo pergjate korridorit te ndertimit ne zonat ku nuk ka studime te meparshme arkeologjike. Si e tille, do te jete e nevojshme per te lejuar arkeologe te kualifikuar per te monitoruar procesin e heqjen e shtreses se dheut gjate procesit te ndertimit te rruges, nderhyrjeve ne peizazh, ose krijimin e zonave te mbetjeve, gjate hapjes se gropave etj. Kjo do te kerkoje bashkepunim te ngushte midis kontraktorit dhe ekipit arkeologjik te mundesuar qe te gjitha punimet te ecin mire dhe te kontrollohen per karakteristika arkeologjike para fillimit te punimeve ne thellesi te metejshme qe do te shkaterronin karakteristika te tilla. Çdo mbetje arkeologjike qe mund te haset gjate germimit duhet te regjistrohet ne nje nivel proporcional me rendesine e saj, ne nje menyre te tille ne menyre per te minimizuar vonesat ne afatet e ndertimit.

Masat mbrojtese te propozuara ne arkeologjine e zones

Parandalimi i ndikimeve te mundshme ne burim eshte opsioni me i mire, dhe qe mund te arrihet nepermjet kontrollit vertikal ose horizontal te zones se shqyrtuar;

- Ruajtja e mbetjeve arkeologjike ne vendin ku ato mund te gjenden eshte zakonisht opsioni i preferuar i trashegimise kulturore sepse i rrit vleren historike dhe kulturore te vendit, por ne rastin e ndertimeve perpara projektuesve vihet alternativa e cila sugjeron perzgjedhjen e asaj me ndikimin me te ulet ne keto mbetje kushtezuar nga faktore te tjere te ndertimit te lidhura direkt ose indirekt me keto mbetje (kostot e devijimit te projektit, fondet per kete qellim etj)
- Reduktimin e efekteve te ndikimeve qe nuk mund te shmangen.
- Eshtrat te cilat mund te klasifikohen si shume te rendesishme nuk duhen neglizhuar; per keto duhet te miratohen opsionet e germimit arkeologjik.

Rekomandime te tjera mund te jepen per te permiresuar vendet e mbetjeve arkeologjike. Kjo mund te perfshije, per shembull, permiresimin e pamjes apo rregullimin e zonave prane tyre me qellim nxjerrjen ne pah te ketyre vlerave.

Masat mbrojtese te propozuara ne cilesine e peizazhit

Objektivat kryesore te zbutjes ekologjike jane per te marre masa per te shmangur ose minimizuar ndikimet negative te skemes mbi vleren ekzistuese per mbrojtjen e natyres se zones si gjate fazes se ndertimit ashtu dhe funksionimit. Aty ku ndikimet negative nuk mund te shmangen ose zvogelohen, do te jete e nevojshme per te permiresuar vleren e natyres permes krijimit te habitateve kompensuese te pershtatshme per lokalitetin.

Mbrojtja e peizazhit dhe bukurive natyrore synon te arrije;

1. Karakteristikat e ekosistemeve dhe llojeve te rralla dhe te rrezikuara;
2. Karakteristikat e peizazhit te promovuar si turistik
3. Vlerat rekreative te peizazhit dhe bukurive natyrore.

Rekomandimet e meposhtme pershkruajne ne menyre me te detajuar llojet e zbutjes qe do te ndermerren per te reduktuar ndikimin e pergjithshem per te permbushur objektivat e meposhtme.

- Te ruhet sa me shume bimesia ekzistuese duke perfshire edhe pemet e vjetra pyjore si dhe mbjelljen e tyre ne ane te rruges ku te jete e mundur, ose aty ku humbjet e meparshme te bimesise e lejojne kete gje.
- Per te minimizuar humbjen apo degradimin e karakteristikave ekzistuese te peizazhit.
- Per te shmangur apo minimizuar aty ku nuk eshte e mundur marrjen e dheut nga vendet e trashegimise ose ato me interes ekologjik, truall nga bizneset lokale apo te perdorur nga komuniteti, duke ulur sa me shume te jete e mundur gjurmen ekologjike te propozimeve;

- Per te shmangur ose zvogeluar ndikimet vizuale gjate nates aty ku eshte e mundur;
- Per te minimizuar ndikimin dhe pastaj per te integruar, propozimet ne peizazhin perreth duke futur modelet karakteristike te mbjelljes dhe duke perdorur lloje bimore qe jane ne perputhje me karakteristikat tradicionale te zones.

Masat zbutese ne toke(truall)

Masa te rekomanduara gjate fazes se ndertimit per te evituar ndotjen e tokes(truallit)

- Te evitohet ne maksimum rrjedhja e vajrave nga automjetet dhe mjetet e ndertimit (ekskavatore, fadroma, vinça, betoniera, etj.)
- Te parashikohen mjete dhe mundesi per mbledhjen e vajrave ne rast derdhjeve aksidentale ne toke dhe ne rrjetin e kanaleve kullues e vadites si edhe te kontraktohen subjekte te posacme te cilat merren me trajtimin e tyre.
- Vendosja e mureve mbajtes apo pritave ne zonat ku do te konstatohet rreziku i rreshqitjes se dherave
- Te shtrohen me beton siperfaqet e pastrimit te automjeteve, ato te ndertimit te vajit te tyre si dhe siperfaqet e stokimit te substancave te tjera ndotese.
- Bitumi, bojerat dhe lendet e tjera toksike te perdoren me kujdes, per te mos ndotur token dhe ujerat.
- Marrja e masave per parandalimin e rreshqitjeve te dheut, shpateve apo erozionit gjate fazes se ndertimit.
- Te evitohet ne maksimum ngjeshja e tokave bujqesore perreth siperfaqes se objektit;
- Punimet e mundshme jashte gjurmes se objektit, te kryhen ne mot te thate, dhe kur toka nuk eshte e lagur
- Te evitohet ne maksimum rrjedhja e vajrave, karburanteve nga mjetet e ndertimit (ekskavatore, fadroma, vinça, betoniera, etj.)
- Te mblidhen ne nje vend te caktuar, ne ene te papershkueshme, ne kantierin e ndertimit, mbeturinat e vajrave, grasove, etj.
- Vendi ku mendohet se mundesia e derdhjes pertoke te vajrave dhe grasove, te mbulohet nga nje shtrese e papershkueshme nga keto lende.
- Te mbahen ne gatishmeri produkte qe thithin keta ndotes ne rast se ndodh ndonje shkarkim ne mjedis i tyre.
- Metodatat me te mira te ndertimit do te ndiqen per perdorimin e pajisjeve te pershtatshme personale mbrojtese (PPM) te cilat do te perdoret per te ndihmuar ne zbutjen e rrezikut potencial per shendetin e njeriut ne rast se gjate ndertimit mund te hasen materiale ndotese

Masat zbutese te rekomanduara ne hidrologji

- Per te mos reduktuar burimet qe sherbejne per furnizimin e ujerave nentokesore apo qe mund te sjellin problem ne furnizimin me uje te komuniteteve lokale duhet te merren ne konsiderate faktore si: stina e pranveres (ku keto ujera kane potencialin me te larte prures), ose periudha e veres kur keto burime kane prurje te ulet; faktore te cilet te konsiderohen ne kohezgjatjen e punimeve.
- Aty ku reduktimi i sasise se ujerave eshte e nevojshem, dhe burimet e ujerave nentokesore (p.sh., burimet e perdorura per furnizimin me uje) jane identifikuar ne zonen e projektit ateher mund te merren masat lehtesuese te tilla si kufizimi ne kohe apo vellimi i sasise se ujit per te reduktuar ndikimin ose mund te kryhen furnizimet alternative te cilat gjithsesi do te kushtezojne kohezgjatjen e punes. Duhet te theksohet se keto aktivitete mund te duhet nje leje sipas Ligjit te Burimeve Ujore te Shqiperise.
- Te zbatohen standardet e kullimit te pershtatshme gjate ndertimit per te zbutur ndikimin e mundshem ne cilesine e ujerave nentokesore nga çlirimi i substancave te rrezikshme (p.sh. naftes dhe ndotesve te tjere);
- Te zbatohen metodatat me te mira te ndertimit ne praktike per parandalimin e ndotjes se ujerave prej

derdhjeve aksidentale apo rrjedhjet e karburantit, naftes ose lubrifikanteve apo shllamit qe mund te krijohet nga depozitimi i mbetjeve ose aktiviteteve te trajtimit te ujerave te zeza;

- Çdo automjet dhe pajisje e perdorur gjate ndertimit duhet te mirembahet dhe te inspektohet rregullisht per rrjedhjet e karburantit, lubrifikantet dhe vaji, dhe pajisjet e duhura duhet te jene ne dispozicion ne kantier per te eliminuar derdhjet te vogla;

- Te gjitha karburantet duhet te ruhen sipas udhezimeve te mira te praktikes, duke perfshire depozitat me nje vellim minimal e ruajtjes se 110% te kapacitetit te depozites

Shkarkimet nga çdo mjet apo pas larjes se gomave duhet te mblidhen dhe riciklohen, kur eshte e mundur, dhe jo te shkarkohen ne toke;

- Tepricat e ujit nga larja e makinerive do te depozitohen brenda nje zone nga e cila duhet te hiqen mbetjet apo balta para shkarkimit te ujit.

- Punimet ne toke mund te çojne ne rritjen trupave te ngurte pezull ne ujerat nentokesore dhe burimet do te minimizohen nga sasia e pergjithshme e tokes se ekspozuar ndaj punimeve te ndertimit, themeleve etj.

- Ujerat e zeza qe rrjedhin nga çdo EC portative te hidhen ne kontejnere te vulosura, te cilat duhet te zbrazen periodikisht ne impiantet e trajtimit te ujerave te zeza.

- Duhet te mbahet nje regjister i veçante per te gjitha llojet e mbetjeve te gjeneruara.

- Ne kantier do te behet nje inspektim per te vezhguar (nese ka) ndotje te ujerave apo te tokes, kjo ne perputhje me standardet kombetare ose evropiane;

- Do te behet nje vleresim i duhur i rrezikut dhe rehabilitimit per te punesuarit ne vende ku mund te konstatohet ujera apo toke e ndotur me qellim marrjen e masave parandaluese.

- Sistemet e kullimit jane te projektuara per te kufizuar depertimin e vajrave, karburanteve apo trupave e ngurte pezull, ne sistemin e ujerave nentokesore ose burime. Sigurimi i zonave te punimeve me prita do te kufizojne ndikimin e mundshem dhe ndalimin e depertimit te ndotesve ne ujerat nentokesore dhe toke.

Aty ku ka potencial per burimet e ujerave nentokesore, gjate gjithë ndertimit, duhet te behet mbikeqyrja e nevojshme ne menyre qe te ruhen njejtat parametra per te siguruar qe mos te ndodhe asnje renie ne cilesine e ujit ose fluksit te prurjes qe shpesh ndodhin si rezultat i zhvillimit te punimeve rrugore. Nese identifikohet nje renie e fluksit apo cilesise duhet verifikuar edhe shkaku si edhe te merren masat e duhura zbutese te vene ne vend situaten.

5.8 Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar

Projekti “**Sistemim - asfaltim rruga Taronine - Zhulat**” L= 5 464 m” nuk është pjesë e projekteve që përfshihen në Ndikimet Ndërkufitare sipas Konventës ESPOO.

Sipas konventës Espoo, neni 1; jep përkufizimin mbi “Ndikim ndërkufitar” i cili nënkupton çdo ndikim, jo vetëm të një natyre globale, brenda zonës në juridiksionin e një Pale, të shkaktuar nga një veprimtari e propozuar, origjina fizike e të cilës ndodhet plotësisht ose pjesërisht brenda fushës së juridiksionit të një Pale tjetër;

Sipas nenit 6 të Ligjit 10440, "Vlerësim ndërkufitar i ndikimeve në mjedis" është procesi i VNM-së, që zhvillohet për projekte ose veprimtari, të përcaktuara në aneksin i të Konventës së Kombeve të Bashkuara (ESPOO) "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkufitar", që, bazuar nga vendndodhja a teknologjia e tyre, mund të kenë ndikime të ndjeshme negative në mjedisin e shteteve fqinje apo të vendit tonë.

Kuadri ligjor:

"Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Nderkufitar", e miratuar në 25 shkurt 1991, në Espoo - Finlande (ratifikuar nga qeveria shqiptare).

Ligji Nr. 9478, datë 16.2.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në vendimet II/14 dhe III/7, amendamente të Konventës së ESPOO-S "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, në kontekst nderkufitar".

Ligji Nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar

Ligji Nr. 9700, datë 26.3.2007 “Për Mbrojtjen e Mjedisit nga Ndikimet Nderkufitare” Ligji Nr. 10440, datë 05.09.2002 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.

Aneksi (Shtojca) i i Konventës së Kombeve të Bashkuara ESPOO (e ndryshuar sipas amendimit të Ligjit Nr. 9478, datë 16.2.2006) përmban të gjithë listën e aktiviteteve, për të cilat kërkohej VNM nderkufitare. Sipas Aneksi i (Shtojca i) e Konventës së Kombeve të Bashkuara ESPOO, projekti “Rikonstruksion i Rruges së fshatit Zhulat nuk është pjesë e projekteve që përfshihen në Ndikimet Ndërkufitare sipas Konventës ESPOO.

6.1 Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor të projektit **“Sistemim - asfaltim rruga Taronine - Zhulat” L= 5 464 m** është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit gjatë dhe në mbyllje të tij.
- Të monitorojë emetimet në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në zonen e projektit dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me projektin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të projektit në rajon.
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajonin e projektit, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

Baza Ligjore e Monitorimit

Monitorimi i mjedisit është detyrim ligjor, mënyra, frekuenca dhe elementët e monitorimit janë të ndryshëm për veprimtari të ndryshme.

Kërkesa ligjore për kryerjen e monitorimit:

- Ligji nr. 10431 datë 09.06.2013 “Për mbrojtjen e mjedisit”, kreu VI “monitorim i gjendjes së mjedisit”; Subjekti është i detyruar të kryejë monitorimet periodike sipas kërkesave të përcaktuara në kushtet e lejes përkatëse mjedisore.

Legjislacioni bazë ku mbështetet monitorimi janë:

Tabela-11: Baza ligjore për monitorimin e projektit

Ligji Nr.10266 datë 15.4.2010	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007	Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis
Ligji 162/2014”	Per Mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis
VKM Nr.1189 datë 18.11.2009	Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit
VKM Nr. 435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve ne ajër në Republikën e Shqipërisë
VKM Nr. 803 datë 04.12.2003	Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit
Udhëzimi Nr.8 datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527 datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkarkuar nga mjetet rrugore, dhe mënyra e kontrollit të tyre. I ndryshuar me: Udhëzimin Nr. 12 datë 15.06.2010
VKM Nr. 177, datë 31.3.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse.
Ligj nr. 10463 dt. 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”	Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet: a) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve; b) përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre; c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

Në përputhje me karakteristikat e projektit dhe në përputhje me bazën ligjore mbi monitorimin, rekomandojmë të monitorohen këto elemente:

Tabela.-12: Sistemi i monitorimit mjedisor gjate ndertimit dhe funksionimit

Komponenti mjedisor	Metoda	Vendndodhja e pikave te matjes/vezhgimit	Frekuenca e marrjes se mostrave	Pergjegjesia
Ujerat nentokesor	Marrje mostrash ne rrjedhat ujore dhe analizat fiziko-kimike te	Rrjeti piezometrik ne vendndodhje te percaktuara	Gjate ndertimit dhe shfrytezimit	Kontraktuesi Klienti ARM
Cilesia e ajrit (pluhuri)	Matja e emetimeve	Rrjeti i monitorimit te pluhurit	Sipas ligjeve shqiptare	Kontraktuesi Klienti ARM
Cilesia e ajrit	Sensorete e gazrave	Rrjeti i monitorimit te emetimeve dhe monitorimi i zonave te ndjeshme rreth kantierit	Rregullisht gjate ndertimit dhe shfrytezimit	Kontraktuesi Klienti ARM
zhurma	Monitorimi i zhurmes dhe vibrimeve	Pika te perzgjedhura midis burimit te zhurmes/vibrimit dhe receptoreve	Rregullisht per te pare nese ka tejkalim te normave Monitorim pas hapjes se rruges(pas 3,6 dhe 9 muajsh).	Kontraktuesi Klienti ARM
Ekologjia	Survejim	Habitatet e reja te sapokrijuara	Kur te jete e nevojshme.	Klienti ARM
Trashegimia kulturore	Veshtrim i shpejte dhe survejim	Zonat ku nuk kane ndodhur ndryshime te medha dhe qe mund te shfaqin interes ne te ardhmen	Gjate heqjes se shtreses se pare te dheut per te pare nese ka mbetje arkeologjike	Kontraktuesi Klienti ARM
Peizazhi	survejim	Zonat e reja te mbjella	Monitorim sipas rastit per te vezhguar nese gjithçka ka shkuar sipas parashikimeve	Kontraktuesi Klienti

7 VLERËSIMI NDIKIMEVE POZITIVE QË MUND TË SJELLË ZHVILLIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

Zhvillimi i këtij projekti shoqerohet me efekte pozitive sociale si vijon:

- Permiresimin e rrjetit rrugor ne pergjithesi dhe zhvillimi urban i cili do te shoqerohet rrjedhimisht edhe permiresimine industrisë turistike te Gjirokastres ,rritjen e cilesise se jetes per banoret dhe perdoruesit e rruges .
- Punësimi i përkohshem për komunitetin i cili do të të marrë pjesë drejtpërdrejt në proceset e ndërtimit, gjë e cila do të sjellë një kontribut të dobishëm në të ardhurat familjare (hapja e vendeve të punës);
- Rritje të ardhurash për shërbimet shtesë që do të duhet të behen për punonjësit që do te merren me ndërtimin e këtij projekti.
- Rritje të ardhurash nga taksat vendore për te gjitha shërbimet e ofruara.

8 KONKLUZIONE

Nga hartimi i ketij raporti paraparak të vlerësimit të ndikimit në mjedis për projektin e propozuar , mund të konkludojmë që:

- Ndikimet potenciale mjedisore te evidentuara janë vleresuar dhe trajtuar sipas standarteve ligjore, metodologjisë dhe rekomandimeve të kërkuara.
- Implementimi i ketij projekti me masat e parashikuara zbutese përfshire planin e monitorimit , është garant i realizimit jo vetem te objektivave por edhe te performances mjedisore në përputhje të plotë me ligjet në fuqi , lidhur me nivelin e shkarkimeve ne mjedis dhe mbrojtjen e saj.
- Nuk evidentohen ndikime sinjifikative te cilat do te ndikonin cilesine e mjedisit apo ate sociale nga implementimi i projektit.
- Projekti ne teresi ne terma mjedisore dhe sociale , konsiderohet projekt me impakte negative minimale dhe te perkoshmshe .

Nga analizimi i përmbajtjes së këtij raporti mund të konkludojmë që implementimi i këtij projekti nuk do të ketë impakte negative sinjifikative në mjedisin përreth zonës së projektit gjatë fazës ndërtimore te tij, ndërkohe që pas fazës ndërtimore fale implementimit të këtij projekti do të kemi përmisim te infrastrukturës rrugore, zhvillim të mëtejshëm te vlerave turistike te Gjirokastres, përmirësim të cilësisë së jetës për komunitetin.

9 REFERENCAT

- Manuali Shqiptar i Projektimit te Rrugeve - MShPRr
- Kushtet Teknike te Projektimit te Rrugeve Automobilistike- 2002.
- Raporti i gjendjes se mjedisit 2014 ne Shqiperi
- Strategjia kombetare e menaxhimit te mbetjeve
- Legjislacioni Shqiptar mbi qeverisjen vendore
- World Health Organisation (WHO), 2005. Air Quality Guidelines: Global Update.
- International Finance Corporation (IFC), April 2007. Environmental Health and Safety Guidelines. Toll Roads, Eorld Bank Group.
- International Finance Corporation (IFC), April 2007. Environmental Health and Safety Guidelines.

General EHS Guidelines: Environmental. World Bank Group.

- Broen, A. E., Burn A. J., Hopkins, J. J. & Eay S. F. (eds) (1997). The Habitats Directive: selection of Special Areas of Conservation in the UK. Joint Nature Conservation Committee Report 270, Peterborough, 295pp
- IEEM (2006). Guidelines for Ecological Impact Assessment in the United Kingdom. Institute of Ecology and Environmental Management
- DfT (Department for Transport), 2007, Design Manual for Roads and Bridges Volume 11 Section 3, Part 2 (HA208/07): Cultural Heritage.
- IFA (Institute for Archaeologists), 2001a, Standard and Guidance for Archaeological Deskbased Assessment
- IFA (Institute for Archaeologists), 2001b, Standard and Guidance for Archaeological Field Evaluation IFA (Institute for Archaeologists), 2001c, Standard and Guidance for an Archaeological Watching Brief IFA (Institute for Archaeologists), 2001d, Standard and Guidance for Archaeological Excavation
- Manualit e Projektimit per Rruget dhe Urat (MPRRU) te Britanise se madhe
- GLVIA 2002. Guidelines for visual and landscape impact assessment

Punoi:
Shoqeria Zenit&Co Shpk

Porosites:
Bashkia Gjirokaster

Expert Mjedisi **Yzeir MIRAKA**